



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

www.qpz.gov.al

Nr.14

25 shkurt

2010

P Ë R M B A J T J A

Faqe

Vendim i KM nr.71, datë 3.2.2010	Për përcaktimin e numrit të punonjësve me kontratë të përkohshme, për vitin 2010, në njësitë e qeverisjes qendrore	441
Udhëzim i MBUMK & MF nr.1, datë 14.1.2010	Mbi zbatimin e vendimit të Këshillit të Ministrave nr.1290, datë 23.12.2009 “Për përcaktimin e kriterëve bazë, të sektorëve që do të mbështeten dhe të masave të përfitimit nga fondi i programit për bujqësinë dhe zhvillimin rural”....	442
Rregullore e MMPAU nr.1, datë 1.2.2010	Për organizimin dhe funksionimin e Komitetit të Monitorimit të organizatave të menaxhimit të peshkimit.....	457
Rregullore e MMPAU nr.9, datë 25.1.2010	Për ngritjen e një sistemi për parandalimin, dekurajimin dhe eliminimin e peshkimit ilegal, të parregulluar e të paraportuar (IUU).....	461

VENDIM
Nr.71, datë 3.2.2010

PËR PËRCAKTIMIN E NUMRIT TË PUNONJËSVE ME KONTRATË TË PËRKOZHSHME,
PËR VITIN 2010, NË NJËSITË E QEVERISJES QENDRORE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2 të nenit 18 të ligjit nr.7961, datë 12.7.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Numri i punonjësve me kontratë të përkohshme, për vitin 2010, për njësitë e qeverisjes qendrore, është 576 veta, sipas lidhjes nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Përfundimisht, për Agjencinë e Legalizimit, Urbanizimit dhe Integritetit të Zonave/Ndërtimeve Informale, nuk zbatohet pika 3 e vendimit nr.1703, datë 24.12.2008 të Këshillit të Ministrave “Për vendosjen e standardeve të shërbimeve dhe veprimtarive sezonale/të përkohshme për ministritë dhe institucionet buxhetore”.

3. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga shpenzimet korrente, të miratuara në buxhetin përkatës të vitit 2010, për njësitë e qeverisjes qendrore, ndërsa për ALUIZNI-n, të përballohen nga të ardhurat e vetë institucionit.

4. Ngarkohet Ministria e Financave të miratojë me hollësi numrin e punonjësve, sipas lidhjes nr.1, të përmendur në pikën 1 të këtij vendimi, brenda kriterëve të vendimit nr.1703, datë 24.12.2008 të Këshillit të Ministrave “Për vendosjen e standardeve të shërbimeve dhe veprimtarive sezonale/të përkohshme për ministritë dhe institucionet buxhetore”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Lidhja nr.1

Gr.	Emri i Institucionit	Nr. punonjësve	Emërtesa	Koha mesatare	Muajt
04	Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës	19			
	Aparati i ministrisë	1	Sanitare	deri 3 orë/ditë	vjetor
	Drejtoria e Përgjithshme e Standardizimit	1	Operatore	deri 5 orë/ditë	vjetor
	Inspektoriat Qendror Teknik	1	Sanitare	deri 3 orë/ditë	vjetor
	Inspektoriat Qendror Teknik	1	Punëtor mirëmbajtjeje në laboratorë	deri 5 orë/ditë	vjetor
	ALBINVEST	1	Sanitar	deri 3 orë/ditë	vjetor
	Shërbimi Gjeologjik	2	Punëtor shpimi	3-5 orë/ditë	vjetor
	Shërbimi Gjeologjik	1	Punëtor rilevimi	3-5 orë/ditë	vjetor
	Shërbimi Gjeologjik	11	Nëpunës roje	8 orë/ditë	5 muaj
06	Ministria e Punëve Publike, Transportit Telekomunikacionit	500			
	ALUIZNI	500	Specialistë/ndihmës specialistë	8 orë/ditë	10 muaj
10	Ministria e Financave	18			
	Spektori i pagesave të dëmshpërblimeve	4	Specialiste	8 orë/ditë	6 muaj
	Spektori i pagesave të dëmshpërblimeve	1	Punonjës arkive	8 orë/ditë	6 muaj
	Drejt. Financimeve, Kontraktimeve/dega e thesarit Tiranë	1	Roje	8 orë/ditë	6 muaj

	Drejtoria e Përgj.Financimeve dhe Kontraktimeve	1	Sanitare	deri 3 orë/ditë	vjetore
	Degët e thesarit	7	Sanitare	deri 3 orë/ditë	vjetore
	Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve	4	Operatore	deri 4 orë/ditë	vjetore
16	Ministria e Brendshme	3			
	Aparati	1	Specialist përkthyes	8 orë/ditë	6 muaj
		2	Teknikë	8 orë/ditë	6 muaj
25	Ministria e Punës dhe Çështjeve Sociale	35			
	Aparati	4	Roje	8 orë/ditë	4 muaj
	Në institucionet e shtëpisë së foshnjës/ moshuarve/qendrat e zhvillimit/qendrat pritëse dhe ditore	21	Mjekë	deri 4 orë/ditë	vjetore
		10	Sanitar	deri 4 orë/ditë	vjetore
77	Autoriteti i Konkurrencës	1			
	Autoriteti i Konkurrencës	1	Teknik mirëmbajtje	6 orë/ditë	12 muaj
	Total numri i punonjësve	576			

UDHËZIM

Nr.1, datë 14.1.2010

MBI ZBATIMIN E VENDIMIT TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE NR.1290, DATË 23.12.2009 “PËR PËRCAKTIMIN E KRITEREVE BAZË, TË SEKTORËVE QË DO TË MBËSHTETEN DHE TË MASAVE TË PËRFITIMIT NGA FONDI I PROGRAMIT PËR BUJQËSINË DHE ZHVILLIMIN RURAL”

Në mbështetje të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.1290, datë 23.12.2009 “ Për përcaktimin e kriterëve bazë, të sektorëve që do të mbështeten dhe të masave të përfitimit nga fondi i programit për bujqësinë dhe zhvillimin rural”,

UDHËZOJMË:

I. Të përgjithshme

1. Fondi i programit për bujqësinë dhe zhvillimin rural është parashikuar në buxhetin e MBUMK për vitin 2010 në zërin “Transferti në buxhetet familjare në shumën 1515 milionë lekë dhe do të përdoret në sektorët si më poshtë:

- Mbjellja e ullishteve, pemëtoreve dhe vreshtave.
- Prodhimi i fidanëve të certifikuar të ullirit.
- Teknologjitë moderne të ujitjes.
- Prodhimi i perimeve në sera.
- Prodhimi blegtoral.
- Prodhimi i produkteve bio.
- Prodhimi i vajit të ullirit.
- Nxitja e kreditimit bankar në sektorin e bujqësisë.

2. Kriteret dhe masa e përfitimit të drejtpërdrejtë nga fondi i programit për bujqësinë dhe zhvillimin rural do të jetë:

a) Mbjellja e ullinjve, agrumeve dhe pemëve frutore 250 000 (dyqind e pesëdhjetë mijë) lekë/ha për format tradicionale dhe 350 000 (treqind e pesëdhjetë mijë) lekë/ha për format intensive të kultivimit të tyre. Sipërfaqja e mbjellë duhet të jetë jo më pak se 2 dynym.

b) Mbjellja e vreshtave 500 000 (pesëqind mijë) lekë/ha. Sipërfaqja e mbjellë duhet të jetë jo më pak se 2 dynym.

c) Ujitja me pika në pemëtore, agrumishte dhe ullishte intensive, në masën 300 000 (treqind mijë) lekë/ha, për sipërfaqet jo më të vogla se 2 dynym.

d) Prodhimi i produkteve bujqësore bio nga bimët e kultivuara, 50 000 lekë/fermë në vit.

e) Blerjen e plastmasit për serrat me ngrohje diellore dhe teknike, 200 000 (dyqind mijë) lekë/ha serrë për sipërfaqet jo më të vogla se 2 dynym.

f) Pagesën me 10 lekë/litër qumësht, për feramat blegtorale, që mbarështojnë 10-50 krerë lopë qumështi të racave të pastra dhe kryqëzimet e tyre. Pagesa të bëhet kundrejt sasisë së qumështit të deklaruar në organet tatimore.

g) Pagesën 500 lekë për kokë dele për tufat me mbi 50 krerë të matrikulluara.

h) Prodhimin e vajit të ullirit extra-vergine, 100 (një qind) lekë/litër për sasi të deri në 15 ton/vit.

3. Nxitja e kreditimit bankar në sektorin e bujqësisë:

a) Mbështetjen, përmes subvencionimit në masën 70% të normës së interesit për 3 vite radhazi për kreditë, që do të merren për ruajtje dhe përpunim të produkteve bujqësore dhe blegtorale, si dhe për mjete mekanike bujqësore. Subvencionimi bëhet për kreditë deri në 15 000 000 (pesëmbëdhjetë milionë) lekë.

b) Krijim fond garancie për kreditimin e aktiviteteve bujqësore të agroindustrialisë, si dhe atyre të orientuara për eksport në masën 50% të vlerës së principalit të kredisë. Garancia bëhet për kreditë deri në 15 000 000 (pesëmbëdhjetë milionë) lekë.

II. Kriteret për të përfutur mbështetje, procedurat e aplikimit, përzgjedhjes, verifikimit dhe pagesës.

1. Mbjellja e ullinjve, agrumeve dhe pemëve frutore (mollë, dardhë, kumbull, qershi, pjeshkë, lajthi, luleshtrydhe) 250 000 (dyqind e pesëdhjetë mijë) lek/ha për format tradicionale dhe 350 000 (treqind e pesëdhjetë mijë) lek/ha për format intensive të kultivimit të tyre.

1.1 Aplikimi

Periudha e aplikimit për mbështetje financiare fillon më 15 janar 2010 dhe përfundon më 28 shkurt 2010.

Aplikimet për mbështetje financiare paraqiten pranë zyrës së bujqësisë në rreth, sipas formularit të kërkesës për aplikim (formulari nr. 1/1).

Kërkesa, dorëzohet në zyrën e bujqësisë së rrethit, e cila plotëson aktpranimin (formulari nr. 1/3). Një kopje e këtij formulari duhet t'i jepet aplikuesit (fermerit).

Zyra e bujqësisë së rrethit regjistron të gjitha kërkesat e paraqitura (bashkë me projektet kur ka të tilla) në Regjistrin e Aplikimit për Rrethin (Formulari nr.1/4) dhe brenda 10 ditëve i dorëzon të dhënat në sektorin e shërbimit këshillimor në DRBUMK në qark, i cili regjistron të gjitha kërkesat e paraqitura në Regjistrin e Aplikimit për Qarkun (formulari nr.1/5)

1.2 Kriteret të përfutimit

a) Në zonën fushore të vendit do të mbështeten kryesisht aplikimet për ngritjen e ullishteve, agrumishteve dhe pemëtoreve intensive të reja. Në zonën kodrinore dhe malore financimi do të orientohet kryesisht në mbjelljen e pemëve frutore. Për ndarjen zonale grupet e vlerësimit duhet t'i referohen aneksit nr.I bashkëngjitur udhëzimit.

b) Toka të jetë në pronësi ose me qira për të paktën 20 vjet për pemë frutore ose agrume dhe 30 vjet për ullinj.

c) Vërtetim nga komuna/bashkia që është paguar taksa e tokës bujqësore, për të cilën po aplikohet, për vitin 2009.

d) Sipërfaqja e mbjellë të jetë e të njëjtës specie.

e) Specia apo kultivari të jenë brenda rajonizimit ose zonimit bujqësor, të përcaktuar nga MBUMK (Aneksi nr. II).

f) Sipërfaqja minimale për t'u mbështetur me financim në pemë frutore dhe agrume është 2 dynym, ndërsa sipërfaqja maksimale është 5 ha.

g) Sipërfaqja minimale për t'u mbështetur me financim në ullishte është 2 dynym, ndërsa sipërfaqja maksimale është 10 ha.

1.3 Kriteret konkurruese

a) Specia 10 pikë.

b) Kultivari 10 pikë.

c) Sipërfaqja e pemëtore/agrumishte/ullishte 25 pikë.

d) Teknologjia që do të përdoret 55 pikë. Nga këto: Kur projekti parashikon edhe ujtime me pika 30 pikë. Përparësi në vlerësim do të kenë ato aplikime që parashikojnë edhe ngritjen e sistemit ujitës me pika. Numri i bimëve për ha 25 pikë (vlerësim maksimal për format intensive të

kultivimit). Në format tradicionale të mbjelljes në pemëtore numri i bimëve nuk duhet të jetë nën 300 bimë për ha, në agrume jo më pak se 400 bimë për ha, në ullishte numri i bimëve në asnjë rast nuk duhet të jetë më pak se 250 bimë/ha. Në mbjelljet intensive numri i bimëve për ha nuk duhet të jetë më pak se 400 rrënjë për ha për ullishtet dhe jo më pak se 800 rrënjë për ha për pemët frutore.

Projektet të cilat parashikojnë përveç mbjelljes së pemëtore/agrumishte/ullishte edhe ngritjen e sistemit të ujitjes me pika, përfitojnë financimin edhe për sistemin e ujitjes sipas vlerës së përcaktuar në udhëzimin.

Fitues mund të jetë çdo projekt me të paktën 60 pikë, por fituesit paguhen sipas rendit prioritar mbi bazën e pikëve të fituara dhe fondit në dispozicion.

Vlerësimi maksimal për specien bëhet në rastin kur kërkohet të mbillet ajo specie, e cila është prioritare për rajonin. (referohu anekseve përkatëse)

Vlerësimin maksimal për sipërfaqen e fiton aplikuesi me sipërfaqe më të madhe, të tjerët vlerësohen në përpjesëtim të drejtë me sipërfaqen më të madhe.

Vlerësimin maksimal për teknologjinë e marrin ato aplikime që parashikojnë ndërhyrje më të mëdha në mobilimin e tokës, si dhe ato aplikime që parashikojnë ngritje pemëtore apo ullishte intensive krahasuar me ato tradicionale.

1.4 Projekti

Bashkëngjitur me kërkesën, aplikuesi duhet të dorëzojë edhe projektin e plotë i cili duhet të përmbajë këta elemente:

- a) Skema e mbjelljes
- b) Specia
- c) Kultivari
- d) Përshkrim i shkurtër i teknologjisë që do të përdoret në ngritjen e pemëtore/agrumishtes/ullishtes.
- e) Afati i ngritjes së pemëtore/agrumishtes/ullishtes.
- f) Preventivi i ngritjes së pemëtore/agrumishtes/ullishtes.
- g) Certifikatën e pronësisë mbi tokën bujqësore d.m.th. aktin e marrjes së tokës në pronësi (tapinë). Në mungesë të kësaj të fundit, fermeri duhet të paraqesë vërtetim nga komuna/bashkia mbi pronësinë e tokës ose kontratën e marrjes me qira të tokës.

Të dhënat e mësipërme pasqyrohen në dokumentin e projektit (formulari nr.1/2).

1.5 Vlerësimi

Në çdo DRBUMK ngrihet “Grupi i vlerësimit të projekteve” i kryesuar nga Drejtori Rajonal i Bujqësisë dhe i përbërë nga 4 anëtarë të tjerë të cilët do të jenë: Përgjegjësi i Sektorit të Shërbimit Këshillimor, Përgjegjësi i Sektorit të Prodhimit Bujqësor, një specialist i pemëtarisë/vreshtarisë/ullirit, si dhe një përfaqësues i AZHBR Qendër.

Vlerësimi i projekteve bëhet vetëm një herë në fund të periudhës së aplikimit, brenda 10 ditëve nga mbyllja e afatit të përcaktuar për aplikim. Grupi i vlerësimit të projekteve në DRBUMK bën vlerësimet e projekteve të paraqitura dhe përcakton projektet fituese. Vlerësimi bëhet me sistem pikësh. (formulari nr.1/6).

Në grupin e vlerësimit në asnjë rast nuk duhet të bëjnë pjesë specialistë që kanë hartuar projekte për fermerët aplikues.

Shpalljen e fituesve e bën DRBUMK nëpërmjet zyrave të bujqësisë në rreth të cilat njoftojnë fermerët që kanë fituar të drejtën e mbështetjes financiare, si dhe i informon ata për procedurat e tjera që do të ndiqen deri në likuidimin e vlerës së parashikuar për mbështetje.

Pas përfundimit të procesit të vlerësimit, DRBUMK-të dërgojnë brenda 5 ditëve në zyrën e AZHBR në rajon listën e plotë të projekteve fituese dhe jo fituese. Dokumentacioni i dorëzuar në zyrën e AZHBR-së në qark duhet të përmbajë dosjen e plotë të aplikimit me dokumentacionin origjinal sipas formularit të dorëzimit (formulari nr.1/7 dhe formulari nr.1/5).

Dosjet e paplotësuara me dokumentacionin përkatës i kthehen DRBUMK-së dhe i lihet një afat prej 10 ditësh për t'i plotësuar ato dhe për t'i ridërguar në zyrën e AZHBR-së në qark.

Fermeri që është përzgjedhur për të përfituar do të mbështetet financiarisht vetëm pasi të ketë ndërtuar pemëtoren, ullishtën ose agrumishten, sipas projektit me të cilin ka aplikuar.

1.6 Verifikimi dhe pagesa

Për verifikimin e realizimit të projekteve fituese dhe plotësimin e dokumentacionit për likuidim, në çdo rreth ngrihet "Grupi i verifikimit" i përbërë nga 2 specialistë të AZHBR në qark dhe një specialist i fushës nga Drejtoria Rajonale e Bujqësisë. Grupi kryesohet nga AZHBR.

Në grupin e verifikimit në asnjë rast nuk duhet të bëjnë pjesë specialistë që kanë hartuar projekte për fermerët aplikues, si dhe ata që kanë qenë pjesë e grupeve të vlerësimit të ngritura nga DRBUMK-të.

Menjëherë pas përfundimit të punës për ngritjen e pemëtores, ullishtes apo agrumishtes fermeri njofton zyrën e AZHBR në rajon, e cila është e detyruar që brenda 15 ditëve nga marrja e njoftimit të dërgojë grupin e verifikimit, i cili bën verifikimin në vend dhe plotëson të dhënat në aktin e verifikimit të realizimit të projektit (formulari nr.1/8).

Në momentin e verifikimit të realizimit të projektit fermeri duhet të paraqesë:

a) Një kopje të certifikatës së garancisë së materialit mbjellës të përdorur (fidanit), të siguruar nga shitësi, si dhe faturën tatimore të blerjes së tyre. Kopja e certifikatës duhet me vulë origjinale (të njomë).

b) Vërtetim nga komuna/bashkia që është paguar taksa e tokës bujqësore, për të cilën po aplikohet, për vitin 2010.

Disa nga të dhënat e kërkuara më lart (në pikat a dhe b) shënohen në aktin e verifikimit të realizimit të projektit (formulari nr. 1/8).

AZHBR duhet të verifikojë të dhënat e marra nga certifikatat e garancisë së materialit mbjellës me ato të Buletinit të Certifikimit që publikohet çdo muaj nga Enti Shtetëror i Farave dhe Fidanëve.

Grupi i verifikimit, brenda 10 ditëve nga përfundimi i verifikimit të projektit, dërgon një kopje të të dhënave (formulari nr.1/8) në AZHBR në qendër. Kjo e fundit, nga ana e saj, kontrollon të gjithë dokumentacionin e paraqitur dhe përgatit për likuidim një përmbledhëse (formulari nr.1/9).

AZHBR, pas verifikimit të zbatimit të procedurave të aplikimit dhe verifikimit, është i detyruar që brenda 30 ditëve të bëjë xhirimin e parave në numrin e llogarisë së përfutjesit.

Xhirimi i parave bëhet me dy këste.

Pas verifikimit të parë sipas procedurave të lartpërmendura likuidohet 70% e vlerës së projektit.

Verifikimi i dytë dhe pagesa për 30% të vlerës së projektit, bëhet gjatë muajve shtator-nëntor 2010. Gjatë kësaj faze të verifikimit të projektit kërkohet:

a) Niveli i zënieve të fidanëve të jetë mbi 90%.

b) Toka të jetë e punuar dhe e pastër nga barishtet e këqija, shkurret, ferrat etj.

Verifikimi i dytë bëhet në jo më pak se 15% të projekteve të vlerësuara dhe të likuiduara në fazën e parë.

Procesi i verifikimit të dytë dhe likuidimit të 30% të pagesës bëhet sipas të gjitha procedurave të përshkruara në pikën 1.6 të këtij udhëzimi.

2. Mbjellja e vreshtave të reja 500 000 (pesëqind mijë) lek/ha. Sipërfaqja e mbjellë duhet të jetë jo më pak se 2 dynym.

2.1 Aplikimi

Perioda e aplikimit për mbështetje financiare fillon më 15 janar 2010 dhe përfundon më 28 shkurt 2010.

Aplikimet për mbështetje financiare paraqiten pranë zyrës së bujqësisë në rreth, sipas formularit të kërkesës për aplikim (formulari nr 2/1).

Kërkesa, dorëzohet në zyrën e bujqësisë së rrethit, e cila plotëson aktpranimin (formulari nr. 2/3). Një kopje e këtij formulari duhet t'i jepet aplikuesit (fermerit).

Zyra e bujqësisë së rrethit regjistron të gjitha kërkesat e paraqitura (bashkë me projektet kur ka të tilla) në Regjistrin e Aplikimit për Rrethin (formulari nr.2/4) dhe brenda 10 ditëve i dorëzon të dhënat në Sektorin e Shërbimit Këshillimor në DRBUMK në qark, i cili regjistron të gjitha kërkesat e paraqitura në Regjistrin e Aplikimit për Qarkun (formulari nr.2/5).

2.2 Kritere të përfitimit

a) Ngritja e vreshtave të reja do të mbështetet vetëm në zonën kodrinore dhe malore të vendit. Për ndarjen zonale grupet e vlerësimit duhet t'i referohen aneksit nr.1 bashkëngjitur udhëzimit.

b) Toka të jetë në pronësi ose me qira për të paktën 20 vjet.

c) Vërtetim nga komuna/bashkia që është paguar taksa e tokës bujqësore, për të cilën po aplikohet, për vitin 2009.

d) Sipërfaqja e mbjellë të ketë jo më shumë se 2 kultivar.

e) Kultivari të jetë brenda rajonizimit ose zonimit bujqësor, të përcaktuar nga MBUMK (aneksi nr. II).

f) Sipërfaqja minimale për t'u mbështetur me financim në vreshtari është 2 dynym, ndërsa sipërfaqja maksimale është 5 ha.

2.3 Kriteret konkurruese

a) Kultivari 20 pikë

b) Sipërfaqja e vreshtit 55 pikë

c) Teknologjia që do të përdoret 25 pikë. (Nga këto: mobilimi i tokës 15 pikë, numri i bimëve për ha 10 pikë. Numri i bimëve në asnjë rast nuk duhet të jetë më pak se 1700 bimë/ha).

Fitues mund të jetë çdo projekt me të paktën 70 pikë, por fituesit paguhet sipas rendit prioritar mbi bazën e pikëve të fituara dhe fondit në dispozicion.

Vlerësim maksimal për kultivarin u jepet atyre aplikimeve që parashikojnë të mbjellin kultivar autokton.

Vlerësimin maksimal për sipërfaqen e fiton aplikuesi me sipërfaqe më të madhe; të tjerët vlerësohen në përpjesëtim të drejtë me sipërfaqen më të madhe.

Vlerësimin maksimal për teknologjinë e marrin ato aplikime që parashikojnë ndërhyrje më të mëdha në mobilimin e tokës, plehërimin, ujitjen etj.

2.4 Projekti

Bashkëngjitur me kërkesën për aplikim përfituesi duhet të dorëzojë edhe projektin e plotë i cili duhet të përmbajë këto elemente:

a) Skema e mbjelljes

b) Specia

c) Kultivari

d) Përshkrim i shkurtër i teknologjisë që do të përdoret në ngritjen e vreshtit.

e) Afati i ngritjes së vreshtit.

f) Preventivi i ngritjes së vreshtit.

g) Certifikatën e pronësisë mbi tokën bujqësore d.m.th. aktin e marrjes së tokës në pronësi (tapinë). Në mungesë të kësaj të fundit fermeri duhet të paraqesë vërtetim nga komuna/bashkia mbi pronësinë e tokës ose kontratën e marrjes me qira të tokës.

Të dhënat e mësipërme pasqyrohen në dokumentin e projektit (formulari nr 2/2).

2.5 Vlerësimi

Në çdo DRBUMK ngrihet "Grupi i vlerësimit të projekteve" i kryesuar nga Drejtori Rajonal i Bujqësisë dhe i përbërë nga 4 anëtarë të tjerë të cilët do të jenë: Përgjegjësi i Sektorit të Shërbimit Këshillimor, Përgjegjësi i Sektorit të Prodhimit Bujqësor, një specialist i pemëtarisë/ vreshtarisë, si dhe një përfaqësues i AZHBR Qendër.

Vlerësimi i projekteve bëhet vetëm një herë në fund të periudhës së aplikimit, brenda 10 ditëve nga mbyllja e afatit të përcaktuar për aplikim. Grupi i vlerësimit të projekteve në DRBUMK bën vlerësimet e projekteve të paraqitura dhe përcakton projektet fituese. Vlerësimi bëhet me sistem pikësh (formulari nr.2/6).

Në grupin e vlerësimit në asnjë rast nuk duhet të bëjnë pjesë specialistë që kanë hartuar projekte për fermerët aplikues.

Shpalljen e fituesve e bën DRBUMK nëpërmjet zyrave të bujqësisë në rreth, të cilat njoftojnë fermerët që kanë fituar të drejtën e mbështetjes financiare, si dhe i informon ata për procedurat e tjera që do të ndiqen deri në likuidimin e vlerës së parashikuar për mbështetje.

Pas përfundimit të procesit të vlerësimit, DRBUMK-të dërgojnë brenda 5 ditëve në zyrën e AZHBR në qark listën e plotë të projekteve fituese dhe jo fituese. Dokumentacioni i dorëzuar në zyrën e AZHBR-së në qark duhet të përmbajë dosjen e plotë të aplikimit me dokumentacionin origjinal sipas formularit të dorëzimit (formulari nr.2/7 dhe formulari nr.2/5).

Dosjet e paplotësuara me dokumentacionin përkatës i kthehen DRBUMK-së dhe i lihet një afat prej 10 ditësh për t'i plotësuar ato dhe për t'i ridërguar në zyrën e AZHBR-së në qark.

Fermeri që është përzgjedhur për të përfituar do të mbështetet financiarisht vetëm pasi të ketë ndërtuar vreshtin sipas projektit me të cilin ka aplikuar.

2.6 Verifikimi dhe pagesa

Për verifikimin e realizimit të projekteve fituese dhe plotësimin e dokumentacionit për likuidim, në çdo rreth ngrihet "Grupi verifikimit" i përbërë nga 2 specialistë të AZHBR në qark dhe një specialist i fushës nga Drejtoria Rajonale e Bujqësisë. Grupi kryesohet nga AZHBR.

Në grupin e verifikimit në asnjë rast nuk duhet të bëjnë pjesë specialistë që kanë hartuar projekte për fermerët aplikues, si dhe ata që kanë qenë pjesë e grupeve të vlerësimit të ngritura nga DRBUMK-të.

Menjëherë pas përfundimit të punës për ngritjen e vreshtit, fermeri njofton zyrën e AZHBR në rajon, e cila është e detyruar që brenda 15 ditëve nga marrja e njoftimit të dërgojë grupin e verifikimit, i cili bën verifikimin në vend dhe plotëson të dhënat në aktin e verifikimit të realizimit të projektit (formulari nr.2/8).

Në momentin e verifikimit të realizimit të projektit fermeri duhet të paraqesë:

a) Një kopje të certifikatës së garancisë së materialit mbjellës të përdorur (fidanit), të siguruar nga shitësi, si dhe faturën tatimore të blerjes së tyre. Kopja e certifikatës duhet me vule origjinale (të njomë).

b) Vërtetim nga komuna/bashkia që është paguar taksa e tokës bujqësore, për të cilën po aplikohet, për vitin 2010.

Disa nga të dhënat e kërkuara më lart (në pikat a dhe b) shënohen në aktin e verifikimit të realizimit të projektit (formulari nr. 2/8).

AZHBR duhet të verifikojë të dhënat e marra nga certifikatat e garancisë së materialit mbjellës me ato të Buletinit të Certifikimit që publikohet çdo muaj nga Enti Shtetëror i Farave dhe Fidanëve.

Grupi i verifikimit, brenda 10 ditëve nga përfundimi i verifikimit të projektit, dërgon një kopje të të dhënave (formulari nr.2/8) në AZHBR në qendër. Kjo e fundit nga ana e saj kontrollon të gjithë dokumentacionin e paraqitur dhe përgatit për likuidim një përmbledhëse (formulari nr.2/9).

AZHBR, pas verifikimit të zbatimit të procedurave të aplikimit dhe verifikimit, është i detyruar që brenda 30 ditëve të bëjë xhirimin e parave në numrin e llogarisë së përfituesit.

Xhirimi i parave bëhet me dy këste.

Pas verifikimit të parë sipas procedurave të lartpërmendura, likuidohet 70% e vlerës së projektit.

Verifikimi i dytë dhe pagesa për 30% të vlerës së projektit, bëhet gjatë muajve shtator-nëntor 2010. Gjatë kësaj faze të verifikimit të projektit kërkohet:

a) Niveli i zënive të fidanëve të jetë mbi 90%.

b) Toka të jetë e punuar dhe e pastër nga barishtet e këqija, shkurret, ferrat etj.

Verifikimi i dytë bëhet në jo më pak se 15% të projekteve të vlerësuara dhe të likuiduara në fazën e parë.

Procesi i verifikimit të dytë dhe likuidimit të 30% të pagesës bëhet sipas të gjitha procedurave të përshkruara në pikën 1.6 të këtij udhëzimi.

3.Ujitjen me pika në pemëtore, agrumishte dhe ullishte intensive në masën 300 000 lekë/ha.

3.1 Aplikimi

Periudha e aplikimit për mbështetje financiare fillon më 1 mars 2010 dhe përfundon më 30 prill 2010.

Aplikimet për mbështetje financiare paraqiten pranë zyrës së bujqësisë në rreth, sipas formularit të kërkesës për aplikim (formulari nr. 3/1).

Kërkesa dorëzohet në zyrën e bujqësisë së rrethit, e cila plotëson aktpranimin (formulari nr. 3/3). Një kopje e këtij formulari duhet t'i jepet aplikuesit (fermerit).

Zyra e bujqësisë së rrethit regjistron të gjitha kërkesat e paraqitura (bashkë me projektet kur ka të tilla) në Regjistrin e Aplikimit për rrethin (formulari nr.3/4) dhe brenda 10 ditëve i dorëzon të dhënat në Sektorin e Shërbimit Këshillimor në DRBUMK në qark, i cili regjistron të gjitha kërkesat e paraqitura në Regjistrin e Aplikimit për qarkun (formulari nr.3/5).

3.2 Kriteret e përfitimit

a) Toka të jetë në pronësi ose me qira për të paktën 20 vjet për pemë frutore dhe agrume dhe të paktën 30 vjet për ullishtet.

b) Vërtetim nga komuna/bashkia që është paguar taksa e tokës bujqësore, për të cilën po aplikohet, për vitin 2009.

c) Mbështetja jepet vetëm për format intensive të kultivimit. Numri i bimëve për ha duhet të jetë: në ullishte jo më pak se 400 bimë/ha, në agrume jo më pak se 400 bimë/ha, në pemë frutore jo më pak se 800 bimë/ha.

d) Sipërfaqja minimale për t'u financuar nuk duhet të jetë më e vogël se 2 dynym dhe sipërfaqja maksimale do të jetë 5 ha për pemëtoret dhe 10 ha për ullishtet dhe agrumet.

e) Sistemi ujitës i ngritur duhet të jetë i plotë me proceset: filtrim, ujitje dhe plehërim.

3.3 Kriteret konkurruese

a) Specia 30 pikë. Brenda qarkut prioritet do të kenë aplikimet për ujitjen me pika në pemëtoret intensive pastaj ullishtet dhe agrumet.

b) Sipërfaqja e pemëtores/ullishtë/agrumishte 40 pikë.

c) Moshë e pemëtores 20 pikë (vlerësimi maksimal për pemëtores/ullishtë/agrumishte të reja).

d) Fermat që aplikojnë kultivim bio 10 pikë.

Fitues mund të jetë çdo projekt me të paktën 70 pikë, por fituesit realë shpallen sipas rendit prioritar mbi bazën e pikëve të fituara.

Vlerësimin maksimal për sipërfaqen e fiton aplikuesi me sipërfaqe më të madhe; të tjerët vlerësohen në përpjesëtim të drejtë me sipërfaqen më të madhe.

3.4 Projekti

Bashkëngjitur me kërkesën për aplikim aplikuesi duhet të dorëzojë edhe projektin e plotë, i cili duhet të përmbajë këto elemente:

a) Sipërfaqen e pemëtores/ullishtes/agrumishte.

b) Specia që kultivon.

c) Prodhimi vjetor i pritshëm (nëse është në prodhim).

d) Vitin e ngritjes së pemëtores/ullishtes/agrumishte.

e) Teknologjia e aplikuar (distancat e mbjelljes, nr. i bimëve/ha, niveli i shërbimeve që kryhen etj).

f) Certifikatën e pronësisë mbi tokën bujqësore d.m.th. aktin e marrjes së tokës në pronësi (tapinë). Në mungesë të kësaj të fundit fermeri duhet të paraqesë vërtetim nga komuna/bashkia mbi pronësinë e tokës ose kontratën e marrjes me qira të tokës.

Të dhënat e mësipërme pasqyrohen në dokumentin e projektit (formulari nr. 3/2).

3.5 Vlerësimi

Në çdo DRBUMK ngrihet "Grupi i vlerësimit të projekteve" i kryesuar nga Drejtori Rajonal i Bujqësisë dhe i përbërë nga 4 anëtar të tjerë të cilët do të jenë: Përgjegjësi i Sektorit të Shërbimit Këshillimor, Përgjegjësi i Sektorit të Prodhimit Bujqësor, një specialist i pemëtarisë/ullirit si dhe një përfaqësues i AZHBR qendër.

Vlerësimi i projekteve bëhet vetëm një herë në fund të periudhës së aplikimit, brenda 10 ditëve nga mbyllja e afatit të përcaktuar për aplikim. Grupi i vlerësimit të projekteve në DRBUMK bën vlerësimet e projekteve të paraqitura dhe përcakton projektet fitues. Vlerësimi bëhet me sistem pikësh. (formulari nr.3/6).

Në grupin e vlerësimit në asnjë rast nuk duhet të bëjnë pjesë specialistë që kanë hartuar projekte për fermerët aplikues.

Shpalljen e fituesve e bën DRBUMK nëpërmjet zyrave të bujqësisë në rreth të cilat njoftojnë fermerët që kanë fituar të drejtën e mbështetjes financiare si dhe i informon ata për procedurat e tjera që do të ndiqen deri në likuidimin e vlerës së parashikuar për mbështetje.

Pas përfundimit të procesit të vlerësimit, DRBUMK-të dërgojnë brenda 5 ditëve në zyrën e AZHBR në qark listën e plotë të projekteve fituese dhe jo fituese. Dokumentacioni i dorëzuar në zyrën e AZHBR-së në qark duhet të përmbajë dosjen e plotë të aplikimit me dokumentacionin origjinal sipas formularit të dorëzimit (formulari nr.3/7 dhe formulari nr.3/5).

Dosjet e paplotësuara me dokumentacionin përkatës i kthehen DRBUMK-së dhe i lihet një afat prej 10 ditësh për t'i plotësuar ato dhe për t'i ridërguar në zyrën e AZHBR-së në qark.

Fermeri që është përzgjedhur për të përfituar do të mbështetet financiarisht vetëm pasi të ketë ndërtuar sistemin ujitës sipas projektit me të cilin ka aplikuar.

3.6 Verifikimi dhe pagesa

Për verifikimin e realizimit të projekteve fituese dhe plotësimin e dokumentacionit për likuidim, në çdo rreth ngrihet "Grupi verifikimit", i përbërë nga 2 specialistë të AZHBR në qark dhe një specialist i fushës nga Drejtoria Rajonale e Bujqësisë. Grupi kryesohet nga AZHBR.

Në grupin e verifikimit në asnjë rast nuk duhet të bëjnë pjesë specialistë që kanë hartuar projekte për fermerët aplikues, si dhe ata që kanë qenë pjesë e grupeve të vlerësimit të ngritura nga DRBUMK-të.

Menjëherë pas përfundimit të punës për ngritjen e sistemit ujitës, fermeri njofton zyrën e AZHBR në rajon, e cila është e detyruar që brenda 15 ditëve nga marrja e njoftimit të dërgojë grupin e verifikimit i cili bën verifikimin në vend dhe plotëson të dhënat në Aktin e Verifikimit të Realizimit të Projektit. (formulari nr.3/8).

Në momentin e verifikimit të realizimit të projektit fermeri duhet të paraqesë edhe këto dokumente:

a) Faturën tatimore të blerjes së materialeve të përdorura për instalimin e sistemit të ujitjes me pika.

b) Vërtetim nga komuna/bashkia që është paguar taksa e tokës bujqësore, për të cilën po aplikohet, për vitin 2010.

Disa nga të dhënat e kërkuara më lart (në pikat a dhe b) shënohen në Aktin e Verifikimit të Realizimit të Projektit (formulari nr. 3/8).

Grupi i verifikimit brenda 10 ditëve nga përfundimi i verifikimit të projektit dërgon një kopje të të dhënave (formulari nr.3/8) në AZHBR në qendër. Kjo e fundit nga ana e saj kontrollon të gjithë dokumentacionin e paraqitur dhe përgatit për likuidim një përmbledhëse (formulari nr.3/9).

AZHBR, pasi merr të gjithë dokumentacionin përkatës dhe pas verifikimit të zbatimit të procedurave të aplikimit dhe verifikimit, është i detyruar që brenda 30 ditëve të bëjë xhirimin e parave në numrin e llogarisë së përfituesit.

4. Prodhimi i produkteve bujqësore bio nga bimët e kultivuara me 50 000 lekë/fermë në vit.

4.1. Aplikimi

Perioda e aplikimit për mbështetje financiare fillon më 1 prill 2010 dhe përfundon më 30 qershor 2010.

Aplikimet për mbështetje financiare paraqiten pranë zyrës së bujqësisë në rreth, sipas formularit të kërkesës për aplikim (formulari nr. 4/1).

Kërkesa, dorëzohet në zyrën e bujqësisë së rrethit, e cila plotëson aktpranimin (formulari nr. 4/3). Një kopje e këtij formulari duhet t'i jepet aplikuesit (fermerit).

Zyra e bujqësisë së rrethit regjistron të gjitha kërkesat e paraqitura në Regjistrin e Aplikimit për Rrethin (formulari nr.4/4) dhe brenda 10 ditëve i dorëzon të dhënat në Sektorin e Shërbimit Këshillimor në qark, i cili regjistron të gjitha kërkesat e paraqitura në Regjistrin e Aplikimit për qarkun (formulari nr.4/5). Këto të dhëna dorëzohen brenda 10 ditëve në zyrën e AZHBR në qark. Dokumentacioni i dorëzuar në zyrën e AZHBR në qark duhet të përmbajë dosjen e plotë të aplikimit, sipas formularit të dorëzimit (formulari nr.4/7 dhe formulari nr.4/5). Ky dokumentacion dorëzohet në zyrën e AZHBR në qendër.

Bashkëngjitur me kërkesën për aplikim fermeri duhet të dorëzojë edhe dokumentet e mëposhtme:

- a) Formularin me të dhënat kryesore të fermës (formulari nr.4/2).
- b) Certifikatën bio ose në kalim (konvertim) të lëshuar nga organizmi certifikues për produktin/et e fermës së tij.
- c) Certifikatën e pronësisë mbi tokën bujqësore d.m.th. aktin e marrjes së tokës në pronësi (tapinë). Në mungesë të saj vërtetim nga komuna/bashkia mbi pronësinë e tokës. Nëse toka është me qira kërkohet kontrata e marrjes me qira të tokës për të paktën 10 vjet.

4.2 Kriteret e përfitimit

- a) Përfitojnë të gjithë ata fermerë që kanë ferma të certifikuar për prodhim bio.
- b) Vërtetim nga komuna/bashkia që është paguar taksa e tokës bujqësore, për të cilën po aplikohet, për vitin 2009.

4.3 Verifikimi dhe pagesa

AZHBR, pasi merr të gjithë dokumentacionin përkatës nga DRBUMK, bën verifikimin e dokumentacionit të paraqitur, si dhe vërteton saktësinë e tij duke marrë të dhënat e nevojshme në KSHPO në MBUMK (formulari nr.4/8). Kërkohet që për çdo certifikatë të lëshuar nga organizmat certifikues, të bëhet verifikimi në KSHPO. Kjo bëhet për të vërtetuar nëse një dokument i tillë është i saktë apo jo. Gjithashtu duhet të dorëzohet nga aplikuesi: Vërtetim nga komuna/bashkia që është paguar taksa e tokës bujqësore, për të cilën po aplikohet, për vitin 2010.

Pas verifikimit, përgatitet lista e përfituesve sipas formularit nr. 4/9. AZHBR është i detyruar që brenda 30 ditëve të bëjë xhirimin e parave në numrin e llogarisë së përfituesit.

5. Blerjen e plastmasit për serat me ngrohje diellore dhe teknike 200 000 lekë/ha serre për sipërfaqet jo më të vogla se 2 dynym.

5.1 Aplikimi

Perioda e aplikimit për mbështetje financiare fillon më 15 janar 2010 dhe përfundon më 30 mars 2010.

Aplikimet për mbështetje financiare paraqiten pranë zyrës së bujqësisë në rreth, sipas formularit të kërkesës për aplikim (formulari nr. 5/1).

Kërkesa për aplikim, dorëzohet në zyrën e bujqësisë së rrethit, e cila plotëson aktpranimin (formulari nr. 5/3). Një kopje e këtij formulari duhet t'i jepet aplikuesit (fermerit).

Zyra e bujqësisë së rrethit regjistron të gjitha kërkesat e paraqitura në Regjistrin e Aplikimit për Rrethin (formulari nr.5/4) dhe brenda 10 ditëve i dorëzon të dhënat në Sektorin e Shërbimit Këshillimor në qark, i cili regjistron të gjitha kërkesat e paraqitura në Regjistrin e Aplikimit për qarkun (formulari nr.5/5).

5.2 Kriteret e përfitimit

- a) Përfitojnë të gjithë fermerët që kanë serra diellore dhe teknike me plastmas për prodhim të perimeve. Nuk përfitojnë serrat për prodhimin e fidanëve dhe luleve.
- b) Madhësia e serrës 2 dynym e lart.
- c) Toka të jetë në pronësi ose me qira për të paktën 10 vjet.
- d) Vërtetim nga komuna/bashkia që është paguar taksa e tokës bujqësore, për të cilën po aplikohet, për vitin 2009.
- e) Nuk përfitojnë ata fermerë që kanë përfutur mbështetje për këtë aktivitet, gjatë vitit 2009.
- f) Gjatë vitit 2010, serra të jetë e kultivuar (në momentin e verifikimit). Kjo vërtetohet gjatë fazës së verifikimit në terren.

g) Plastmasi i blerë të jetë cilësor me afat përdorimi jo më pak se trevjeçar, tipi long life dhe trashësia të jetë jo më pak se 180-220 mikron.

5.3 Kriteret konkurruese

a) Rajonizimi (zona ku ndodhet serra) 10 pikë. Prioritet ka zonat fushore në Lushnjë, Berat, Fier, Elbasan, Durrës dhe Tiranë.

b) Madhësia e serrës 70 pikë. Vlerësimi maksimal për serrën me sipërfaqe më të madhe. Për aplikimet e tjera vlerësimi bëhet në raport me sipërfaqen më të madhe.

c) Tipi i serrës 20 pikë. Vlerësimi maksimal për serrat me konstruksion metalik (xingato).

5.4 Vlerësimi

Në çdo DRBUMK ngrihet “Grupi i vlerësimit të projekteve”, i kryesuar nga Drejtori Rajonal i Bujqësisë dhe i përbërë nga 4 anëtarë të tjerë, të cilët do të jenë: Përgjegjësi i Sektorit të Shërbimit Këshillimor, Përgjegjësi i Sektorit të Prodhimit Bujqësor, një specialist i perimeve, si dhe një përfaqësues i AZHBR qendër.

Vlerësimi bëhet vetëm një herë në fund të periudhës së aplikimit, brenda 10 ditëve nga mbyllja e afatit të përcaktuar për aplikim. Vlerësimi bëhet me sistem pikësh (formulari nr.5/6).

Në grupin e vlerësimit në asnjë rast nuk duhet të bëjnë pjesë specialistë që kanë hartuar projekte për fermerët aplikues.

Shpalljen e fituesve e bën DRBUMK nëpërmjet zyrave të bujqësisë në rreth, të cilat njoftojnë fermerët që kanë fituar të drejtën e mbështetjes financiare, si dhe i informon ata për procedurat e tjera që do të ndiqen deri në likuidimin e vlerës së parashikuar për mbështetje.

Pas përfundimit të procesit të vlerësimit, DRBUMK-të dërgojnë brenda 5 ditëve në zyrën e AZHBR në qark listën e plotë të projekteve fituese dhe jofituese. Dokumentacioni i dorëzuar në zyrën e AZHBR-së në qark duhet të përmbajë dosjen e plotë të aplikimit me dokumentacionin origjinal sipas formularit të dorëzimit (formulari nr.5/7 dhe formulari nr.5/5).

Dosjet e paplotësuara me dokumentacionin përkatës i kthehen DRBUMK-së dhe i lihet një afat prej 10 ditësh për t'i plotësuar ato dhe për t'i ridërguar në zyrën e AZHBR-së në qark.

Fermeri që është përzgjedhur për të përfutur do të mbështetet financiarisht vetëm pasi të ketë përfunduar ndërrimin e plastmasit sipas aplikimit të paraqitur.

5.5 Verifikimi dhe pagesa

Menjëherë pas përfundimit të punës fermeri njofton zyrën e AZHBR në rajon, e cila është e detyruar që brenda 15 ditëve nga marrja e njoftimit të dërgojë grupin e verifikimit, i cili bën verifikimin në vend dhe plotëson të dhënat në Aktin e Verifikimit të Realizimit të Projektit (formulari nr.5/8).

Verifikimi bëhet në dy periudha: e para deri në fund të muajit maj 2010 dhe e dyta gjatë muajve shtator -nëntor 2010.

“Grupi i verifikimit” përbëhet nga dy specialistë të AZHBR në qark dhe një specialist i perimeve nga Drejtoria Rajonale e Bujqësisë. Grupi kryesohet nga AZHBR.

Në momentin e verifikimit në terren kërkohet:

a) Plastmasi të jetë blerë/ ndërruar në vitin 2010.

b) Fermeri t'i paraqesë komisionit faturën tatimore të shpenzimeve të kryera për blerjen e plastmasit.

c) Sera të jetë e kultivuar me perime në momentin e verifikimit.

d) Vërtetim nga komuna/bashkia që është paguar taksa e tokës bujqësore, për të cilën po aplikohet, për vitin 2010.

Zyra e AZHBR në qark, brenda 10 ditëve nga verifikimi në terren i serrës, dërgon të dhënat e marra në AZHBR në qendër (formulari nr. 5/9).

AZHBR brenda 30 ditëve nga data e marrjes dhe verifikimit të dokumentacionit është i detyruar të bëjë xhirimin e parave në numrin e llogarisë së përfutuesit.

6. Pagesën, me 10 lekë/litër qumësht, për fermat blegtorale që mbarështojnë 10-15 krerë lopë qumështi të racave të pastra dhe kryqëzime të tyre. Pagesa bëhet kundrejt sasisë së qumështit të deklaruar në organet tatimore.

6.1 Aplikimi

Periudha e aplikimit për mbështetje financiare fillon më 1 maj 2010 dhe përfundon më 30 qershor 2010.

Aplikimet për mbështetje financiare paraqiten pranë zyrës së bujqësisë në rreth, sipas formularit të kërkesës për aplikim (formulari nr. 6/1).

Kërkesa dorëzohet në zyrën e bujqësisë së rrethit, e cila plotëson aktpranimin (formulari nr. 6/3). Një kopje e këtij formulari duhet t'i jepet aplikuesit (fermerit).

Zyra e bujqësisë së rrethit regjistron të gjitha kërkesat e paraqitura në Regjistrin e Aplikimit për Rrethin (formulari nr.6/4) dhe brenda 10 ditëve i dorëzon të dhënat në Sektorin e Shërbimit Këshillimor në qark, i cili regjistron të gjitha kërkesat e paraqitura në Regjistrin e Aplikimit për qarkun (formulari nr.6/5).

DRBUMK brenda 10 ditëve nga marrja e kërkesave i përcjell ato në zyrën e AZHBR në qark. Dokumentacioni i dorëzuar duhet të përmbajë dosjen e plotë të aplikimit me dokumentacionin origjinal, sipas formularit të dorëzimit (formulari nr.6/7 dhe formulari nr.6/5).

Dosjet e paplotësuara me dokumentacionin përkatës i kthehen DRBUMK-së dhe i lihet një afat prej 10 ditësh për t'i plotësuar ato dhe për t'i ridërguar në zyrën e AZHBR-së në rajon.

6.2 Kriteret e përfitimit

- a) Ferma duhet të jetë e regjistruar si subjekt në organet tatimore.
- b) Fermerët duhet të kenë lopë të matrikulluara.
- c) Madhësia e fermës: 10-50 krerë lopë qumështi.
- d) Fermat me më pak se 10 krerë dhe me më shumë se 50 krerë lopë qumështi nuk përfitojnë.
- e) Certifikatë veterinare e tufës (lopëve).
- f) Kontratë dorëzimi të prodhimit të qumështit në një qendër përpunimi ose grumbullimi.
- g) Sasia e shitur e qumështit duhet të jetë e vërtetuar me fatura tatimore të lëshuara nga subjekti prodhues (fermeri).
- h) Sasia maksimale e qumështit për të cilën bëhet pagesa është 2000 litra/krerë/lope brenda vitit 2010.

6.3 Verifikimi dhe pagesa

Për verifikimin e gjendjes së fermës, nga AZHBR ngrihet "Grupi i verifikimit", i përbërë nga dy specialistë të AZHBR në qark dhe një specialist blegtorie nga Drejtoria Rajonale e Bujqësisë. Grupi kryesohet nga AZHBR.

AZHBR është e detyruar që brenda 15 ditëve nga marrja e njoftimit të dërgojë grupin e verifikimit i cili bën verifikimin në vend dhe plotëson të dhënat në Aktin e Verifikimit të Fermës Blegtorale të Gjedisë (formulari nr.6/8).

Verifikimi bëhet në periudhën 1 gusht -30 tetor 2010.

AZHBR, pasi merr formularët dhe dokumentacionin e plotësuar nga grupi i verifikimit, kontrollon të gjithë dokumentet e paraqitura dhe harton një përmbledhëse (formulari nr.6/9), si dhe bashkëngjijt dhe kopje të formularit nr.6/8 për çdo përfitues.

AZHBR pas verifikimit të zbatimit të procedurave të verifikimit, është i detyruar që brenda 30 ditëve të bëjë xhirimin e parave në numrin e llogarisë së përfituesit.

7. Pagesën 500 (pesëqind) lekë për kokë dele, për tufat me mbi 50 krerë dele, të matrikulluara.

7.1 Aplikimi

Aplikimi bëhet në dy faza: e para 01-30 prill 2010 dhe e dyta 01 gusht-30 shtator 2010.

Aplikimet për mbështetje financiare paraqiten pranë zyrës së bujqësisë në rreth, sipas formularit të kërkesës për aplikim (formulari nr.7/1).

Kërkesa dorëzohet në zyrën e bujqësisë së rrethit, e cila plotëson aktpranimin (formulari nr.7/3). Një kopje e këtij formulari duhet t'i jepet aplikuesit (fermerit).

Zyra e bujqësisë së rrethit regjistron të gjitha kërkesat e paraqitura në Regjistrin e Aplikimit për Rrethin (formulari nr.7/4) dhe brenda 10 ditëve i dorëzon të dhënat në Sektorin e Shërbimit Këshillimor në qark, i cili regjistron të gjitha kërkesat e paraqitura në Regjistrin e Aplikimit për qarkun (formulari nr.7/5).

DRBUMK brenda 10 ditëve nga marrja e kërkesave i përcjell ato në zyrën e AZHBR në qark. Dokumentacioni i dorëzuar duhet të përmbajë dosjen e plotë të aplikimit me dokumentacionin origjinal, sipas formularit të dorëzimit (formulari nr.7/7 dhe formulari nr.7/5).

Dosjet e paplotësuara me dokumentacionin përkatës i kthehen DRBUMK-së dhe i lihet një afat prej 10 ditësh për t'i plotësuar ato dhe për t'i ridërguar në zyrën e AZHBR-së në rajon.

7.2 Kriteret e përfitimit

- a) Fermerë që kanë dele të matrikulluara.
- b) Madhësia e tufës mbi 50 krerë.
- c) Certifikatë veterinare të tufës.

7.3 Verifikimi dhe pagesa

Për verifikimin e gjendjes së fermës, nga AZHBR ngrihet “Grupi i verifikimit”, i përbërë nga dy specialistë të AZHBR në qark dhe një specialist blegtorie nga Drejtoria Rajonale e Bujqësisë. Grupi kryesohet nga AZHBR.

AZHBR është e detyruar që brenda 15 ditëve nga marrja e njoftimit të dërgojë grupin e verifikimit i cili bën verifikimin në vend dhe plotëson të dhënat në Aktin e Verifikimit të Fermës Blegtorale të Gjedit (formulari nr.7/8).

AZHBR, pasi merr formularët dhe dokumentacionin e plotësuar nga grupi i verifikimit, kontrollon të gjitha dokumentet e paraqitura dhe harton një përmbledhëse (formulari nr.7/9), si dhe bashkëngjit dhe kopje të formularit nr.7/8 për çdo përfitues.

AZHBR pas verifikimit të zbatimit të procedurave të verifikimit është i detyruar që brenda 30 ditëve të bëjë xhirimin e parave në numrin e llogarisë së përfituesit.

8. Prodhimin e vajit të ullirit extra-vergine, 100 (njëqind) lekë/litër për sasi të deri 15 ton/vit.

8.1 Aplikimi

Aplikimi bëhet dy herë në vit: i pari 15 janar-28 shkurt 2010 dhe i dyti 15 shtator-30 tetor 2010.

Aplikimet për mbështetje financiare paraqiten pranë zyrës së bujqësisë në rreth, sipas formularit të kërkesës për aplikim (formulari nr.8/1).

Kërkesa dorëzohet në zyrën e bujqësisë së rrethit, e cila plotëson aktpranimin (formulari nr.8/3). Një kopje e këtij formulari duhet t’i jepet aplikuesit (fermerit).

Zyra e bujqësisë së rrethit regjistron të gjitha kërkesat e paraqitura në Regjistrin e Aplikimit për rrethin (formulari nr.8/4) dhe brenda 10 ditëve i dorëzon të dhënat në Sektorin e Shërbimit Këshillimor në qark, i cili regjistron të gjitha kërkesat e paraqitura në Regjistrin e Aplikimit për qarkun (formulari nr.8/5).

DRBUMK brenda 10 ditëve nga marrja e kërkesave i përcjell ato në zyrën e AZHBR në qark. Dokumentacioni i dorëzuar duhet të përmbajë dosjen e plotë të aplikimit me dokumentacionin origjinal sipas formularit të dorëzimit (formulari nr.8/7 dhe formulari nr.8/5).

Dosjet e paplotësuara me dokumentacionin përkatës i kthehen DRBUMK-së dhe i lihet një afat prej 10 ditësh për t’i plotësuar ato dhe për t’i ridërguar në zyrën e AZHBR-së në rajon.

8.2 Kriteret e përfitimit

- a) Përfitojnë vetëm përpunuesit e vajit të ullirit.
- b) Përfitojnë vetëm ata përpunues të vajit të ullirit që janë të regjistruar në degën taksa – tatimeve të rrethit përkatës dhe që nuk kanë detyrime financiare të pashlyera.
- c) Përfitojnë vetëm ata përpunues të vajit të ullirit që ruajnë prodhimin në tanker (cisternë) inox.
- d) Mbështetja financiare jepet për prodhuesit e vajit të ullirit extra-vergine të cilësisë së lartë i cili plotëson standardet teknike sipas formularit 8/2.
- e) Sasia maksimale për pagesë është 15 ton brenda vitit 2010.

8.3 Verifikimi dhe pagesa

AZHBR është e detyruar që, brenda 10 ditëve nga marrja e kërkesës, të dërgojë grupin e verifikimit, i cili bën marrjen e mostrës për analizë dhe plotëson të dhënat, sipas formularit të marrjes së mostrës (formulari nr.8/2).

Pranë AZHBR ngrihet “Grupi i verifikimit”, i përbërë nga dy specialistë të AZHBR në qark dhe një specialist i fushës nga Drejtoria Rajonale e Bujqësisë përkatëse. Grupi kryesohet nga AZHBR.

Grupi i verifikimit, nëpërmjet AZHBR-së, dërgon mostrën për analizë në laboratorin e Institutit të Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë (ISUV) në Tiranë. Mënyra e marrjes së mostrës dhe të dhënat që shoqërojnë atë janë ato të procedurave standarde të mostrimit për analiza

laboratorike. Mostra duhet të jetë e koduar dhe pa emër subjekti.

Treguesit e vajit, sipas formularit nr. 8/6, pasqyrohen me fletëanalizë të lëshuar nga Instituti i Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë (ISUV). Shpenzimet për kryerjen e analizave laboratorike të mostrave të vajit përballohen nga aplikuesi (prodhuesi i vajit). Pagesa bëhet 15 ditë pas marrjes së përgjigjes së analizave nga AZHBR.

Pas përfundimit të analizave dhe daljes së rezultatit, AZHBR njofton aplikuesin për rezultatin e analizës. Aplikuesi (prodhuesi i vajit) do të përfitojë mbështetjen e parashikuar vetëm pas shitjes së vajit të cilësisë së lartë (ekstra vergine) me faturë tatimore.

Me të përfunduar shitjen, prodhuesi i vajit njofton AZHBR-në, e cila brenda 10 ditëve nga data e njoftimit është e detyruar të dërgojë përsëri grupin e verifikimit i cili bën verifikimin në vend të gjendjes fizike të vajit, si dhe faturat e shitjes. Në përfundim të verifikimit plotësohet formulari i verifikimit të shitjes (formulari nr.8/8).

AZHBR, pas verifikimit të shitjes së vajit harton një përmbledhëse (formulari nr.8/9), si dhe bashkëngjijt dhe kopje të formularit nr.8/8 për çdo përfitues.

AZHBR pas kontrollit të zbatimit të procedurave të aplikimit dhe verifikimit është e detyruar që brenda 30 ditëve të kryejë xhirimin e parave në numrin e llogarisë së përfituesit.

9. Mbështetjen, përmes subvencionimit në masën 70% të normës së interesit për tre vite radhazi për kreditë, që do të merren për ruajtje dhe përpunim të produkteve bujqësore dhe blegtorale, si dhe për mjete mekanike bujqësore. Subvencioni bëhet për kreditë deri në 15 000 000 lekë.

9.1 Aplikimi për subjekte fizikë/juridikë

Aplikimet për mbështetje financiare paraqiten nga data 1 mars deri më 30 prill 2010. Bashkëngjitur me kërkesën për aplikim subjekti fizik/juridik duhet të dorëzojë edhe projektin e plotë, i cili duhet të përmbajë këto të dhëna:

a) Note premtimi ose ofertë kredie lëshuar nga banka. Ky është një dokument me të cilin banka i premtton subjektit lidhjen e kontratës së kredisë.

b) Dokumentin e regjistrimit në tatim - taksa.

c) Dokument nga zyra e tatimeve që vërteton se subjekti nuk ka detyrime tatimore.

d) Makinerinë apo pajisjen për të cilën kërkon kredi, si dhe marrëveshje paraprake ose ofertë për blerjen e tyre. Makineritë ose pajisjet duhet të jenë të prodhuara për BE.

e) Të paraqesë biznesplanin e detajuar (3- vjeçar), i cili duhet të përfshijë:

- Prezantimin e shoqërisë ose subjektit fizik apo juridik, aktivitetin (nëse ka), regjistrimin si biznes pranë tatimeve, historikun bankar dhe financiar (nëse ka).

- Pasqyrat financiare (plan investimit, analizat e qarkullimit të parasë (cash flow), burimet e financimit).

f) Subjekti duhet të paraqesë certifikatë pronësie që do të përdoret për kolateralin.

Dokumentet e mësipërme mund të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Aplikimet për mbështetje financiare paraqiten në AZHBR qendër, sipas formularit të kërkesës për aplikim (formulari nr. 9/1).

AZHBR plotëson aktpranimin (formulari nr.9/2 ose formulari nr.9/2a). Një kopje e këtij formulari duhet t'i jepet aplikuesit .

AZHBR regjistron të gjitha kërkesat e paraqitura (bashkë me projektet kur ka të tilla) në Regjistrin e Aplikimit për rrethin (formulari nr. 9/3) dhe pastaj në Regjistrin e Aplikimit për qarkun (formulari nr.9/4).

9.2 Aplikimi për mekanikë bujqësore (fermerët)

Aplikimet për mbështetje financiare paraqiten nga data 1 mars deri më 30 prill 2010. Bashkëngjitur me kërkesën për aplikim, fermeri duhet të dorëzojë edhe dokumentacionin e mëposhtëm:

a) Note premtimi ose ofertë kredie lëshuar nga banka. Ky është një dokument me të cilin banka i premtton subjektit lidhjen e kontratës së kredisë.

b) Certifikatën e pronësisë mbi tokën bujqësore d.m.th. aktin e marrjes së tokës në pronësi (tapinë). Në mungesë të saj vërtetim nga komuna/bashkia mbi pronësinë e tokës. Nëse toka është me qira kërkohej kontrata e marrjes me qira të tokës për të paktën 10 vjet.

- c) Llojin e mekanikës bujqësore për të cilën kërkon kredi.
- d) Aktivitetin bujqësor që kryen (perime, pemëtari, ullishte, vreshtë apo fermë blegtorale).
- e) Certifikatë pronësie që do të përdoret si kolateral.

Dokumentet e mësipërme mund të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Aplikimet për mbështetje financiare paraqiten në AZHBR qendër, sipas formularit të kërkesës për aplikim (formulari nr. 9/1).

AZHBR plotëson aktpranimin (formulari nr.9/2 ose formulari nr.9/2a). Një kopje e këtij formulari duhet t'i jepet aplikuesit .

AZHBR regjistron të gjitha kërkesat e paraqitura (bashkë me projektet kur ka të tilla) në Regjistrin e Aplikimit për rrethin (formulari nr. 9/3) dhe pastaj në Regjistrin e Aplikimit për qarkun (formulari nr.9/4).

9.3 Kriteria të përfitimit për subjekte fizike/juridike

a) Përfitojnë subjektet fizike/juridike që merren me ruajtje dhe përpunim të produkteve bujqësore dhe blegtorale që janë të regjistruara në organet tatimore.

b) Përfitojnë subjektet fizike/juridike që kërkojnë të blejnë linja për përpunim të produkteve bujqësore dhe blegtorale (linja për përpunim të frutave, perimeve, qumështit apo thertore).

c) Përfitojnë subjektet fizike/juridike që kërkojnë të blejnë dhoma ruajtje frigoriferike.

d) Përfitojnë subjektet fizike/juridike që kërkojnë të ndërtojnë magazina për grumbullim, përpunim apo ruajtje produktesh bujqësore dhe blegtorale.

9.4 Kriteria të përfitimit për fermerë që aplikojnë për mjete mekanike.

a) Aplikimi bëhet për kredi jo më të vogla se 1 milion lekë.

b) Përfitojnë fermerët që kanë mbi 2 ha tokë bujqësore arë/pemëtore/ullishte/vreshtë, mbi 5 dynym serrë diellore ose me ngrohje, fermerë me mbi 30 krerë lopë qumështi.

c) Përfitojnë ata fermerë që së bashku me traktorin blejnë edhe një agregat bujqësor: makinë mbjellëse/plug/freze/disk/pompe spërkatëse.

d) Fermeri duhet të ketë certifikatën e pronësisë mbi tokën bujqësore, d.m.th. aktin e marrjes së tokës në pronësi (tapinë). Në mungesë të saj vërtetim nga komuna/bashkia mbi pronësinë e tokës. Nëse toka është me qira kërkohet kontrata e marrjes me qira të tokës për të paktën 10 vjet.

9.5 Kriteret konkurruese për subjekte fizike/juridike.

a) Koha prej të cilës ushtron aktivitetin subjekti: 10 pikë. Vlerësimi maksimal për subjektet të cilat kanë qenë aktive vitet e fundit në tregun bujqësor.

b) Zona ku ushtron aktivitetin subjekti: 20 pikë Vlerësimi maksimal bëhet për subjektet që zhvillojnë aktivitetin e tyre në zonat me potencial të lartë bujqësor.

c) Biznes plan i detajuar trevjeçar 25 pikë. Plani më i argumentuar dhe më i besueshëm për t'u realizuar do të ketë vlerësimin maksimal.

d) Kapitali që zotëron (materiale apo financiare) 25 pikë. Subjektet që kanë kapitale më të mëdha monetare ose materiale të vlerësohen maksimalisht.

e) Aktivitet me cikël të mbyllur 20 pikë. Subjektet që prodhojnë, grumbullojnë dhe përpunojnë produkte bujqësore dhe blegtorale vlerësohen maksimalisht.

9.6 Kriteret konkurruese për mekanikën bujqësore

a) Sipërfaqja e fermës/numri i krerëve 70 pikë.

b) Fermat me drejtim kultivim të perimeve/blegtori 30 pikë.

9.7 Vlerësimi

AZHBR në qendër, me mbarimin e afatit të aplikimit dhe marrjen e kërkesave, brenda muajt maj 2010 bën vlerësimin e kërkesave të paraqitura dhe përzgjedhjen e subjekteve/fermerëve fitues. "Grupi i vlerësimit të aplikimeve" përbëhet nga një komision prej 5 (pesë) përfaqësuesish të AZHBR.

Grupi i vlerësimit të aplikimeve bën vlerësimet e kërkesave të paraqitura dhe përcakton subjektet/fermerët fitues, sipas formularit nr. 9/6 ose formularit nr. 9/6a.

Niveli maksimal i vlerësimit do të jetë 100 pikë. Konsiderohen fitues ato aplikime që vlerësohen në nivelin 70-100 pikë.

Subjekti/fermeri që është përzgjedhur për të përfutur do të zgjedhë vetë bankën/shoqërinë e kreditimit për mbështetje me kredi.

Për përfitimin e kredisë bankare subjekti/fermeri do t'u nënshtrohet të gjitha rregullave që aplikojnë sot bankat/shoqëritë e kreditit në vend.

Për të subvencionuar normën e interesit subjekti/fermeri duhet të paraqesë pranë AZHBR planin e shlyerjes së kredisë, si dhe kontratën me bankën /shoqërinë e kreditimit përkatëse. Pas miratimit të kredisë AZHBR duhet të lidhë kontratë/marrëveshje me bankën/shoqërinë kredituese.

9.8 Verifikimi dhe pagesa

Për verifikimin e realizimit të punës dhe plotësimin e dokumentacionit për likuidim, në çdo qark ngrihet "Grupi verifikimit" i përbërë nga dy specialistë të AZHBR dhe një specialist nga Drejtoria Rajonale e Bujqësisë. Grupi kryesohet nga AZHBR. Në përfundim të verifikimit plotësohet formulari nr. 9/7 ose formulari 9/7a.

AZHBR pas verifikimit të zbatimit të procedurave të aplikimit dhe verifikimit, është i detyruar që brenda 30 ditëve të bëjë xhirimin e parave (shumën e normës së interesit të subvencionuar) në numrin e llogarisë së bankës/shoqërisë kredituese me të cilën përfituesi ka kontratë.

III. Kontrolli për administrimin e fondit dhe çështje të tjera

1. ABZHR është përgjegjëse për zbatimin, auditimin, kontrollin dhe likuidimin e parave të përfituesve nga fondi i programit për mbështetjen e prodhimit bujqësor.

2. Ndarjen e fondit të mbështetjes sipas qarqeve e bën ose e ndryshon, kur është e nevojshme gjatë zbatimit, Ministri i MBUMK, me propozim të AZHBR dhe DPPB.

3. Specialistët që marrin pjesë në grupet e vlerësimit të projekteve, në asnjë rast nuk duhet të marrin pjesë edhe në grupet e verifikimit të realizimit të projekteve. Personat që ndihmojnë aplikuesit në hartimin e projekteve nuk duhet të marrin pjesë në grupet e vlerësimit dhe as në ato të verifikimit.

4. Komisionet (grupet) e verifikimit të projekteve ngrihen me urdhër të drejtorit të AZHBR-së pas marrjes së propozimit nga DRBUMK-të për përfaqësuesin e tyre në komision.

5. Masat e mbështetjes kanë kodin e tyre. Ky kod ka formën: MBUMK__2010__01 ku dy shifrat e fundit tregojnë numrin e masës, p.sh. mbjellja e pemëve frutore 01, mbjellja e vreshtave 02 etj.

6. Çdo aplikant përveç emrit ka kodin e aplikimit. Kodi i aplikimit ka të dhëna për qarkun, rrethin, komunën ose bashkinë, numrin e masës mbështetëse, numrin e aplikimit sipas regjistrit të rrethit. P.sh.: KO_KO_01_01 tregon aplikantin me nr.1 nga qarku dhe rrethi Korçë, masa mbjellje pemë frutore. Kodin e krijon AZHBR dhe ai ka për qëllim të lehtësojë ruajtjen dhe përpunimin e të dhënave mbi zbatimin e mbështetjes.

7. Drejtoritë Rajonale të Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit janë përgjegjëse për të gjithë procedurat e aplikimit dhe seleksionimit të përfituesve nga fondi për mbështetjen e prodhimit bujqësor me përjashtim të pikës 9 në "Kriteret për të përfituar mbështetje, procedurat e aplikimit, përzgjedhjes, verifikimit dhe pagesës".

8. I gjithë dokumentacioni që lidhet me vlerësimin e aplikuesve në fondin e mbështetjes, i plotësuar sipas formularëve bashkëngjitur këtij udhëzimi, që i përcillet për administrim AZHBR-së duhet të jetë pa korrigjime dhe i firmosur nga grupet e vlerësimit të projekteve dhe i vulosur nga DRBUMK-të.

9. AZHBR është e detyruar që për një periudhë 10- vjeçare të ruajë nga një kopje të dokumentacionit (dosjen e plotë) për çdo përfitues.

10. DRBUMK dhe AZHBR raportojnë në mënyrë periodike për menaxhimin e fondit të mbështetjes së prodhimit bujqësor. MBUMK nga ana e saj raporton çdo tremujor për ecurinë e realizimit të programit të mbështetjes në Ministrinë e Financave për numrin e përfituesve, masën e përfitimit, sipërfaqet e mbjella, prodhimin bujqësor të realizuar etj.

11. Kur nga verifikimi rezulton që nga ana e një aplikanti fitues sipërfaqja e mbjellë apo numri i krerëve fakt është më i vogël ai i aplikuar, atëherë AZHBR aplikon sanksionet si më poshtë: Kur ndryshimi është më pak se 10% aplikuesi nuk penalizohet, kur ndryshimi është nga 10-25% aplikuesi penalizohet duke i zbritur 20% të vlerës së llogaritur për përfitim, kur ndryshimi është 25%-50% aplikuesi penalizohet duke i zbritur 40% të vlerës së llogaritur për përfitim dhe kur ndryshimi është mbi 50% atëherë aplikuesi skualifikohet nga e drejta për përfitim.

12. Pas çdo procesi vlerësimi, lista e fituesve për çdo masë veçmas nga komisioni në qark i përcillet AZHBR. Në rast rialokimesh të fondeve nga një masë në tjetrën, lista e fituesve që do të paguhet përcaktohet nga AZHBR në bazë të radhës sipas listave.

13. Kur aplikimet kanë projekt, aplikanti duhet të caktojë një person të aftë teknikisht në rolin e zbatuesit të projektit.

14. AZHBR harton dhe zbaton një plan për informimin dhe ndërgjegjësimin e publikut dhe përfituesve potencialë.

15. Aplikuesit të cilët nuk kanë përfituar nga përzgjedhja e bërë nga grupi i vlerësimit dhe që kanë ankesa për procesin e përzgjedhjes ose ndaj procesit të verifikimit i paraqesin ato tek ABZHR në qendër e cila brenda 15 ditëve nga marrja e ankesës bën verifikimin përkatës dhe i jep përgjigje ankuesit.

16. Mbështetja bëhet vetëm për projekte ose masa që zbatohen ose përfundojnë brenda vitit 2010, përveç subvencionimit të interesave për kreditë në kuadrin e mbështetjes së vitit 2008-2009.

17. Ministri i Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit dhe Ministri i Financave kur e gjykojnë të nevojshme kërkojnë ngritjen e grupit të përbashkët të auditimit për të verifikuar administrimin e fondit.

18. Në rast se konstatohen shkelje të rregullave në administrimin e fondit nga personat përgjegjës në DRBUMK-të apo në AZHBR, merren masa disiplinore apo zhdëmtim për çdo rast, sipas dispozitave ligjore në fuqi.

19. Për zbatimin e këtij udhëzimi ngarkohen AZHBR, Ministria e Financave dhe Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë.

MINISTRI I BUJQËSISË, USHQIMIT DHE
MBROJTJES SË KONSUMATORIT
Genc Ruli

MINISTRI I FINANCEVE
Ridvan Bode

RREGULLORE
Nr.1, datë 1.2.2010

**PËR ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E KOMITETIT TË MONITORIMIT TË
ORGANIZATAVE TË MENAXHIMIT TË PESHKIMIT**

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës, të germës “rr” të nenit 9, si dhe pikës 1 të nenit 31/7 të ligjit nr.7908, datë 5.4.1995 “Për peshkimin dhe akuakulturën”, i ndryshuar, Ministri i Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave miraton rregulloren si më poshtë:

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Qëllimi

Rregullorja synon të sigurojë funksionimin normal e të efektshëm të Komitetit të Monitorimit të veprimtarisë së organizatave të menaxhimit të peshkimit (OMP), që ngrihet dhe vepron në Ministrinë e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, duke detajuar rregullat dhe procedurat e organizimit dhe të veprimtarisë së tij.

Neni 2

Objekti

Objekt i rregullores është:

a) zhvillimi cilësor i procesit monitorues të veprimtarive praktike të OMP-ve, me qëllim që ato të aftësohen për të realizuar misionin që u ka caktuar ligji;

b) garantimi i përdorimit të aseteve që u janë transferuar OMP-ve në përdorim, në përputhje me ligjin.

Neni 3

Përbërja e Komitetit

Komiteti i Monitorimit drejtohet nga zëvendësministri që mbulon ujërat dhe peshkimin dhe ka në përbërje 6 anëtarë:

- | | |
|---|---------|
| 1. Drejtori i Drejtorisë së Burimeve Ujore të Peshkimit | anëtar; |
| 2. Drejtori i Ndërmarrjes së Rritjes së Midhjes dhe Zënies së Peshkut | anëtar; |
| 3. Drejtori i Projektit të Portit të Peshkimit | anëtar; |
| 4. Specialist në sektorin e Inspektoratit të Peshkimit | anëtar; |
| 5. Përgjegjës sektori në Drejtorinë e Burimeve Ujore dhe Peshkimit | anëtar; |
| 6. Përgjegjës i sektorit të financë – buxhetit | anëtar; |

KREU II

MONITORIMI I OMP-VE

Neni 4

Detyrat e komitetit

1. Komiteti i Monitorimit të OMP-ve ka për detyrë të krijojë dhe të bëjë funksional sistemin për monitorimin e gjithanshëm të veprimtarisë së OMP-ve; të analizojë treguesit që dalin nga monitorimi; të zbulojë prirjet dhe tendencat që vërehen në ecurinë e OMP-ve; të informojë ministrin për problemet që dalin, duke sugjeruar edhe masat që duhen marrë për përmirësimin e gjendjes.

2. Për realizimin e funksioneve të tij, komiteti monitoron veprimtarinë e OMP-ve mbi bazën e indikatorëve të gjendjes dhe të menaxhimit të aseteve në përdorim:

a) indikatorë të gjendjes, me anë të të cilëve saktësohet gjendja reale dhe situata konkrete për secilën OMP;

b) indikatorë të menaxhimit të aseteve, me anë të të cilëve monitorohet shkalla dhe mënyra e menaxhimit të aseteve të dhëna në përdorim.

3. Komiteti monitoron veprimtarinë e OMP-ve për:

a) zbatimin e statutit të tyre;

b) zbatimin e rregulloreve të menaxhimit të porteve dhe qendrave të peshkimit;

c) veprimtarinë organizative e administrative;

d) veprimtarinë financiare dhe dokumentacionin financiar;

e) kryerjen e investimeve të reja dhe mirëmbajtjen e infrastrukturës ekzistuese në portet dhe qendra e peshkimit;

f) zbatimin e marrëveshjes “tip” për transferimin në përdorim të porteve dhe qendrave të peshkimit, si dhe të kushteve të kontratës së transferimit në përdorim të tyre;

g) zbatimin e planeve të miratuara për bashkëmenaxhimin e burimeve peshkore në hapësirat ujore ku ushtron veprimtarinë e saj çdo OMP;

h) përdorimin e porteve dhe qendrave të peshkimit nga persona jo anëtarë të OMP-së.

KREU III FUNKSIONIMI I KOMITETIT

Neni 5 Kolegjaliteti

1. Komiteti funksionon si organizëm kolegjal. Ai e ushtron veprimtarinë e tij në mbledhje të rregullta pune që zhvillohen të paktën një herë në 6 muaj.
2. Për çdo mbledhje anëtarët përgatisin me shkrim materialet mbi të cilat do të përpilohet raporti që do t'i paraqitet ministrit.
3. Në raportin që harton komiteti jepet situata dhe gjendja e përgjithshme e OMP-ve, rezultatet e monitorimit për çdo OMP, si dhe i propozohen ministrit masa për përmirësimin e situatës.

Neni 6 Ndarja e detyrave

1. Komiteti funksionon mbi bazën e ndarjes së detyrave, ku secili anëtar ka detyra të caktuara, në përputhje me funksionet dhe detyrat që kryen, sipas përcaktimeve të nenit 3 të kësaj rregulloreje.
2. Në periudhën midis dy mbledhjeve, çdo anëtar i komitetit, në zbatim të detyrës funksionale, grumbullon të dhëna që do të përdoren për hartimin e raportit.
3. Përgjegjësi i sektorit të Drejtorisë së Burimeve Ujore dhe Peshkimit luan rolin e sekretarit teknik të komitetit për përgatitjen e mbledhjeve dhe për ruajtjen e dokumentacionit.

Neni 7 Kontrolli i dokumentacionit të OMP-ve

Për hartimin e raportit, komiteti mbështet edhe rezultatet e veprimtarisë kontrolluese që ushtrojnë drejtoritë e specializuara të ministrisë, sipas detyrave funksionale që kryejnë, duke kontrolluar dokumentacionin e OMP-ve në lidhje me:

- a) regjistrin e anëtarëve të OMP-ve;
- b) regjistrin për jo anëtarët;
- c) planin e bashkëmenaxhimit;
- d) regjistrin për kontributet, tarifat, kuotat dhe detyrimet e tjera që paguhen nga anëtarët dhe jo anëtarët e OMP-ve;
- e) llogaritë e të ardhurave dhe shpenzimeve;
- f) inventarin e të gjitha aseteve në portet dhe qendrat e peshkimit;
- g) protokollet e mbledhjeve të Asamblesë së Përgjithshme të Këshillit Administrativ të stafeve ekzekutive etj;
- h) regjistrin për inspektimin dhe kontrollet;
- i) regjistrin për kontratat dhe transaksionet.

Neni 8 Të dhënat e dorëzuara nga OMP-të

1. Për hartimin e raportit përdoren edhe të dhënat që dalin nga bilanci dhe regjistrat financiarë të çdo OMP-je, që brenda 60 ditëve nga përfundimi i vitit financiar i dorëzon ato në Komitetin e Monitorimit.
2. Për çështjet që bëhen objekt shqyrtimi, si dhe për problemet që do t'i relatojë ministrit, komiteti organizon seanca dëgjimi me drejtues të OMP-ve për t'u njohur me mendimet e tyre.

Neni 9
Regjistri i organizatave

Komiteti i Monitorimit kontrollon regjistrin e OMP-ve, të formatuar nga Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave. Regjistri përmban të dhënat e mëposhtme:

- a) emrin e organizatës;
- b) selinë qendrore të organizatës;
- c) vendndodhjen e zonës së peshkimit të kësaj OMP-je;
- d) numrin e anëtarëve;
- e) emrat, adresat, numrat e telefonit të Këshillit Administrativ dhe të kryetarit të OMP-së;
- f) datën e depozitimit të bilancit të fundit vjetor dhe një kopje të tij.

Neni 10
Mbikëqyrja dhe masat

1. Në zbatim të nenit 31/7, pika 3 të ligjit nr.7908, datë 5.4.1995 “Për peshkimin dhe akuakulturën”, i ndryshuar, Komiteti i Monitorimit:

a) Kur gjen shkelje financiare ose prova se OMP-ja nuk ka funksionuar në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore, i kërkon Këshillit të saj Administrativ të thërrasë mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme, ku paraqiten shkeljet e vërejtura.

b) Nëse Këshilli Administrativ nuk e thërret mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme brenda 30 ditëve, komiteti pezullon Këshillin Administrativ dhe e thërret vetë këtë mbledhje.

c) Kur Këshilli Administrativ pezullohet, komiteti i propozon ministrit emërimin e një drejtuesi të përkohshëm të OMP-së derisa mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme të caktojë një këshill administrativ të ri.

d) Kur vëren se asetet nuk janë menaxhuar sipas legjislacionit në fuqi ose jo në përputhje me udhëzimin e përbashkët nr.1, datë 10.12.2003 të Ministrisë së Financave dhe Ministrisë së Bujqësisë dhe Ushqimit “Për administrimin e pasurisë shtetërore në përdorim të organizatave të menaxhimit të peshkimit (OMP)” dhe/ose janë shkelur kushtet e marrëveshjeve ose kontratave të lidhura ndërmjet OMP-ve dhe NRRMZP-së, i kërkon kësaj ndërmarrjeje të prishë marrëveshjen ose kontratën e dhënies në përdorim të aseteve me OMP-në përkatëse.

e) Komiteti i Monitorimit mund të kërkojë të kontrollojë të gjithë dokumentacionin ose pjesë të tij në rast se kjo kërkohet.

2. Për çdo masë që merr sipas pikës 1 të këtij neni, Komiteti i Monitorimit merr miratimin e ministrit.

Neni 11
Shpërndarja e organizatës

Në zbatim të nenit 31/10 të ligjit 7908, datë 5.4.1995 “Për peshkimin dhe akuakulturën”, i ndryshuar:

1. Kur organizata e menaxhimit të peshkimit shpërndahet nga vetë Asambleja e Përgjithshme, Komiteti i Monitorimit regjistron vendimin e shpërndarjes, përgatit urdhrin e ministrit për shpërndarjen e organizatës dhe e publikon atë në Fletoren Zyrtare.

2. Komiteti i Monitorimit, kur vëren se organizata i është shmangur qëllimit për të cilin është krijuar apo nuk është në gjendje të plotësojë në praktikë detyrat, i propozon ministrit shpërndarjen e organizatës.

Neni 12

Me hyrjen në fuqi të kësaj rregulloreje, rregullorja nr.3, datë 16.5.2006 “Për organizimin dhe funksionimin e komitetit të monitorimit të organizatave të menaxhimit të peshkimit”, shfuqizohet.

Neni 13
Hyrja në fuqi

Kjo rregullore hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I MJEDISIT, PYJEVE DHE
ADMINISTRIMIT TË UJËRAVE
Fatmir Mediu

RREGULLORE¹
Nr.9, datë 25.1.2010

**PËR NGRITJEN E NJË SISTEMI PËR PARANDALIMIN, DEKURAJIMIN DHE
ELIMINIMIN E PESHKIMIT ILEGAL, TË PARREGULLUAR E TË PARAPORTUAR
(IUU)**

Në mbështetje të pikës 4 të nenit 102 të Kushtetutës dhe në zbatim të gërmës “n” të nenit 32, të ligjit nr.7908, datë 5.4.1995, “Për Peshkimin dhe Akuakulturën” i ndryshuar, të Kreut III të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.1062, datë 16.7.2008 “Për përcaktimin e kompetencave të inspektoratit të peshkimit dhe ngritjen e sistemit të kontrollit, për zbatimin e politikave menaxhuese në peshkim”, Ministri i Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, miraton rregulloren si më poshtë:

KREU I
TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Qëllimi dhe fusha e veprimtarisë

1. Rregullorja harton një sistem masash për tregtimin e produkteve peshkore me synim parandalimin, dekurajimin dhe eliminimin e peshkimit ilegal, të parregulluar e të paraportuar (peshkimi IUU).

2. Ministria siguron mjetet e duhura në dispozicion të Inspektoratit të peshkimit për t’i mundësuar atij përmbushjen e detyrave të përcaktuara në këtë Rregullore.

3. Rregullorja zbatohet për të gjithë aktivitetet e peshkimit IUU dhe aktivitete të tjera të lidhura me të kur këto aktivitete ushtrohen:

(i) në territorin e ujërave detare, që i nënshtrohen sovranitetit apo juridiksionit të Republikës së Shqipërisë;

(ii) nga anijet shqiptare të peshkimit në detin Mesdhe, jashtë zonave të përcaktuara në pikën (i);

(iii) nga shtetas shqiptarë, në detin Mesdhe, jashtë ujërave të përcaktuara në pikën (i);

¹ Rregullorja transponon pjesërisht Rregulloren Nr. 1005 e 29 shtator 2008 Për ngritjen e një sistemi komunitar për parandalimin, dekurajimin dhe eliminimin e peshkimit ilegal, të parregulluar e të paraportuar dhe Rregulloren Nr. 1010 të datës 22 tetor 2009 për hartimin e rregullave të detajuara për zbatimin e Rregullores (EC) nr. 1005/2008 Për ngritjen e një sistemi komunitar për parandalimin, dekurajimin dhe eliminimin e peshkimit ilegal, të parregulluar e të paraportuar.

Neni 2 Përkufizimet

Në kuptim të kësaj Rregullore:

1. “peshkim ilegal, i parregulluar dhe i paraportuar” ose “peshkim IUU” (Illegal, Unreported and Unregulated) kuptohen aktivitetet e peshkimit që janë ilegale, të parregulluara apo të paraportuara;

2. “peshkim ilegal kuptohen aktivitetet e peshkimit që:

a) kryhet nga një anije peshkimi vendase apo e huaj në ujërat detare nën juridiksionin Republikës së Shqipërisë, pa lejen e saj, apo në shkelje të dispozitave ligjore të legjislacionit shqiptar,

b) kryhet nga një anije peshkimi që mban flamurin e Republikës së Shqipërisë, por që ushtron aktivitetin në kundërshtim me masat menaxhuese dhe konservuese të adoptuara nga organizata të rëndësishme rajonale të menaxhimit të peshkimit ku Shqipëria është palë kontraktuese dhe që ajo ka pranuar, apo të dispozitave të rëndësishme të ligjit ndërkombëtar të aplikueshëm për këtë rast, si dhe

c) kryhet nga anijet e peshkimit në shkelje të dispozitave të legjislacionit shqiptar apo ndërkombëtar;

3. “peshkim i paraportuar” kuptohen aktivitetet e peshkimit që:

a) nuk janë raportuar, apo janë raportuar në mënyrë jo korrekte në autoritetet e rëndësishme kombëtare të peshkimit, në kundërshtim të rregulloreve dhe ligjeve kombëtare të peshkimit, ose

b) janë kryer në zonën e kompetencës së një organizate të rëndësishme rajonale të menaxhimit të peshkimit dhe nuk janë raportuar ose janë raportuar në mënyrë jo korrekte, në kundërshtim me procedurat raportuese të asaj organizate;

4. “peshkim i parregulluar” kuptohen aktivitetet e peshkimit që:

a) kryhen në zonën e aplikimit të një organizate të rëndësishme rajonale të menaxhimit të peshkimit nga anije peshkimi pa nacionalitet, nga anije peshkimi që kanë flamurin e një Shteti jo anëtar i kësaj organizate apo nga ndonjë njësi tjetër peshkimi, që nuk përputhet apo është në kundërshtim me masat konservuese apo menaxhuese të kësaj organizate, ose

b) kryhet në zona ose mbi popullata peshkimi në lidhje me të cilin nuk ka masa të aplikueshme konservuese ose menaxhuese nga anijet e peshkimit që nuk përputhet me përgjegjësitë e Republikës së Shqipërisë për ruajtjen e burimeve detare të gjalla sipas ligjit ndërkombëtar;

5. “anije peshkimi” është anije e çfarëdo madhësie që përdoret apo që synohet të përdoret për shfrytëzimin e burimeve peshkore për qëllime tregtare, duke përfshirë anijet mbështetëse, anijet përpunuese të peshkut, anijet e përfshira në transbordim dhe anijet transportuese të pajisura për transportimin e produkteve peshkore, përjashtuar anijet e konteinerëve;

6. “anije peshkimi shqiptare” është anije peshkimi me flamur shqiptar dhe e regjistruar në Regjistrin Detar Shqiptar;

7. “anije peshkimi komunitare” është anije peshkimi me flamurin e një Shteti Anëtar dhe e regjistruar në komunitet;

8. “leje peshkimi” është e drejta për t’u përfshirë në aktivitete peshkimi gjatë një periudhe caktuar në një zonë të përcaktuar ose për një lloj peshkimi të përcaktuar sipas përcaktimeve të gërmës “i” të nenit 3 ligjit Nr. 10081, datë 23.2.2009 “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë dhe të përcaktimeve të pikës 7 të Kategorisë III.5 (Shfrytëzimi dhe/ose mbarështimi faunës (tokësore dhe ose ujore)), ndarja II. Leja për përdorimin me kodin nënkategorisë III.5.A.1 të Aneksit 1, Fusha III “Mjedisi dhe burimet mjedisore bazë” të VKM Nr.538, datë 26.5.2009 “Për licencat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet qendrës kombëtare të licencimit (QKL) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta”

9. “produkt peshkor” është çdo produkt i cili futet në Kapitullin 3 dhe në kapitujt e Tarifave 1604 dhe 1605 të Nomenklaturës së Kombinuar të përcaktuara nga Rregullorja e Këshillit (EEC) 2658/87 e 23 korrik 1987 mbi nomenklaturën e tarifave dhe statistikave dhe në Tarifën e Përbashkët Doganore, si dhe në Nomenklaturën Doganore shqiptare, me përjashtim të produkteve të listuara në Shtojcën I të kësaj Rregullore;

10. “masa menaxhuese dhe konservuese” janë masat për të mbrojtur apo menaxhuar një ose më shumë lloje të burimeve të gjalla ujore që janë adoptuar dhe janë në fuqi në përputhje me rregullat e rëndësishme dhe/ose legjislacionin shqiptar;

11. “transbordim” do të thotë shkarkimi i plotë ose i pjesshëm i produkteve peshkore në kuvertën e një anije peshkimi nga një anije tjetër peshkimi;

12. “importim” do të thotë futja e produkteve peshkore në territorin e Shqipërisë, përfshirë dhe ato për qëllime transbordimi në portet që ndodhen në territorin e tij;

13. “transporti indirekt” do të thotë importimi nga territori i një vendi të tretë të ndryshëm nga Shteti flamur, anija e së cilit ka kryer zënien;

14. “eksportimi” do të thotë lëvizja në një vend të tretë të produkteve peshkore të marra nga anije peshkimi që mbajnë flamurin shqiptar duke përfshirë ato të marra nga territoret e Republikës së Shqipërisë, nga vendet e treta apo nga zonat e peshkimit;

15. “rieksportim” do të thotë çdo lëvizje nga territori i Shqipërisë, i produkteve të peshkimit, që janë importuar paraprakisht në territorin e Shqipërisë;

16. “organizatë rajonale e menaxhimit të peshkimit” një organizatë rajonale, nën-rajonale apo me kompetenca të ngjashme, e njohur sipas ligjit ndërkombëtar, për të hartuar masa konservuese dhe menaxhuese për burimet e gjalla ujore të vendosura nën përgjegjësinë e saj bazuar në marrëveshjen apo konventën nën të cilën ajo është formuar;

17. “palë kontraktuese” do të thotë pala kontraktuese në marrëveshjen apo konventën që është formuar organizata rajonale e menaxhimit të peshkimit si dhe Shtetet, njësi peshkuese apo çdo njësi tjetër që bashkëpunon me një organizatë të tillë dhe që i është dhënë statusi i palës jo kontraktuese bashkëpunuese në lidhje me këtë organizatë;

18. “vëzhgim” është çdo observim i bërë autoritetet kompetente të Shqipërisë, përgjegjëse për inspektimin në det, apo nga kapiteni i një anije peshkimi, i një anije peshkimi shqiptare apo të vendeve të treta që mund të përfshihet në një ose disa nga kriteret e parashikuara në Nenin 3(1);

19. “rrezik” do të thotë mundësia që një ngjarje mund të ndodhë, në lidhje me produktet peshkore të importuara apo të eksportuara nga territoret e Komunitetit, të cilat pengojnë zbatimin korrekt të kësaj Rregullore apo të masave konservuese dhe menaxhuese;

20. “menaxhimi i rrezikut” do të thotë identifikimi sistematik i rrezikut dhe zbatimi i të gjitha masave të nevojshme për të kufizuar përballimin me këtë rrezik. Këtu përfshihen aktivitete si mbledhja e informacioneve dhe të dhënave, analizimi dhe vlerësimi i rrezikut, përcaktimi dhe kryerja e veprimeve, dhe monitorimi dhe rishikimi i rregullt i procesit dhe rezultateve të tij bazuar mbi burimet apo strategjitë kombëtare, komunitare apo ndërkombëtare;

21. “det i hapur” përfshin të gjitha ato pjesë detare të përcaktuara në Nenin 86 të Konventës së Kombeve të Bashkuara të Ligjit për Detin (UNCLOS);

22. “spedicion” do të thotë produktet që janë të dërguara njëkohësisht nga një eksportues drejt një pritësi, apo të mbuluara nga një dokument i vetëm transporti që mbulon dërgimin e tyre nga dërguesi drejt pritësit, apo në mungesë të një dokumenti të tillë, nga një faturë e vetme.

Neni 3

Anijet e peshkimit që kryejnë aktivitet peshkimi IUU

1. Një anije peshkimi do të konsiderohet se ka kryer peshkim IUU nëse, është në kundërshtim me masat mbrojtëse dhe menaxhuese të aplikuara për zonën e peshkimit të interesuar, si dhe:

a) ka peshkuar pa një licencë, autorizim apo leje të vlefshme, të lëshuar nga Shteti Flamur apo Shteti bregdetar i interesuar, ose

b) nuk ka plotësuar detyrimet e saj në lidhje me regjistrimin dhe raportimin e zënieve apo të dhënave të lidhura me zëniet, duke përfshirë të dhënat që transmetohen me sistemin e vëzhgimit të anijeve, apo njoftimet paraprake; ose

c) ka peshkuar në një zonë të mbyllur, gjatë një sezoni të mbyllur, pa ose pas plotësimit të kuotave ose përtej një thellësisë së përcaktuar, ose

d) ka ushtruar peshkimin e drejtpërdrejtë mbi një popullatë e cila është objekt moratoriumi apo për të cilën është e ndaluar peshkimi; ose

e) përdor vegla peshkimi të ndaluara ose që nuk janë në përputhje me normat; ose

f) fallsifikon ose fsheh regjistrimin, identitetin ose shenjat e tij dalluese; ose

g) fsheh, prish ose eliminon provat në lidhje me një hetim, ose

h) pengon punën e zyrtarëve që janë duke ushtruar detyrat e tyre në inspektimin për kontrollin e masave mbrojtëse dhe menaxhuese në fuqi, ose punën e vëzhguesve që ushtrojnë detyrat e tyre në lidhje me vëzhgimin e përputhjes me legjislacionin shqiptar në fuqi; ose

i) marrin në bord, transbordojnë apo zbarkojnë peshk nën madhësi në kundërshtim me legjislacionin në fuqi; ose

j) transborduar apo ka marrë pjesë në aktivitete peshkimi të përbashkëta, duke mbështetur apo furnizuar anije të tjera peshkimit të identifikuar si pjesëmarrëse në aktivitete peshkimi IUU sipas kësaj rregulloreje, sidomos ato të përfshira në Listën e Anijeve IUU Komunitare apo në listën e anijeve IUU të organizatave rajonale të menaxhimit të peshkimit; ose

k) ka kryer aktivitete peshkimi në zonën e një organizate rajonale të menaxhimit të peshkimit në një mënyrë jo të përshtatshme ose në kundërvajtje të masave mbrojtëse dhe menaxhuese të kësaj organizate, dhe ka flamurin e një Shteti jo pjesë e kësaj organizate, apo jo bashkëpunuese me këtë organizatë siç është përcaktuar nga kjo organizatë; ose

l) nuk ka kombësi pra është një anije pa shtet sipas me ligjeve ndërkombëtare.

2. Aktivitetet e parashtruara në pikën 1 të këtij neni do të konsiderohen si shkelje serioze në varësi të madhësisë së shkeljes në fjalë e cila përcaktohet nga autoritetet kompetente të Shqipërisë, duke marrë parasysh disa kritere si dëmi i shkaktuar, vlerën e tij, madhësinë e shkeljes apo përsëritjen e tij, sipas nenit 39 të ligjit 7908 datë 5.4.1995 “Për peshkimin dhe akuakulturën” i ndryshuar.

KREU II

SKEMA E ÇERTIFIKIMIT TË ZËNIEVE PËR IMPORTIMIN DHE EKSPORTIMIN E PRODUKTEVE PESHKORE

Neni 4

Certifikatat e zënieve

1. Ndalohet eksporti i produkteve peshkore të përfituara nga peshkimi IUU.

2. Për të siguruar efikasitetin e ndalimit të parashikuar në pikën 1 të mësipërm, produktet peshkore eksportohen vetëm kur ato janë të shoqëruara nga një certifikatë zënie në përputhje me këtë rregullore.

3. Çertifikata e zënieve e parashikuar në pikën 2 më sipër, merr vlefshmërinë nga Inspektorati i peshkimit i portit përkatës i anijes apo anijeve të peshkimit të cilat kanë kryer zëniet nga janë përfituar produktet peshkore. Ajo përdoret për të certifikuar se këto zënie janë bërë në përputhje me ligjet, rregulloret dhe masat e rëndësishme menaxhuese dhe mbrojtëse ndërkombëtare në fuqi.

4. Çertifikata përmban të gjithë informacionin e specifikuar në modelin e paraqitur në Shtojcën II, bashkëlidhur kësaj rregulloreje, dhe i jepet vlefshmëria nga Inspektorati i peshkimit që ka kompetencën e nevojshme për të kontrolluar vërtetësinë e informacionit. Çertifikata e zënieve bazohet në të dhënat e plotësuara nga libri i anijes së peshkimit që ka kryer zëniet nga të cilat janë përfituar produktet peshkore. Në marrëveshje apo në kuadër të bashkëpunimit, certifikata e zënieve formohet, i jepet vlefshmëria, paraqitet në mënyrë elektronike apo zëvendësohet nga sisteme të gjurmueshmërisë elektronike, duke siguruar të njëjtin nivel kontrolli nga autoritetet.

5. Lista e produkteve të paraqitura në Shtojcën I, bashkëlidhur kësaj rregulloreje, që përjashtohen nga qëllimi i zbatimit të certifikatës së zënieve, mund të rishikohet çdo vit, bazuar mbi rezultatet e informacioneve të mbledhura.

Neni 5

Skema e dokumentimit të zënieve e miratuar dhe në fuqi në kuadër të organizatave rajonale të menaxhimit të peshkimit

1. Dokumentet e zënieve dhe çdo dokument tjetër në lidhje me to, që është i vlefshëm në përputhje me skemat e dokumentimit të zënieve të adoptuara nga organizatat rajonale të menaxhimit të peshkimit të cilat njihen si të pajtueshme me kërkesat e paraqitura në këtë Rregullore, pranohen si certifikata zënie në lidhje me produktet peshkore për llojet në të cilat këto skema dokumentimi të zënieve aplikohen dhe do të jenë subjekt i kërkesave të verifikimit dhe kontrollit.

2. Kërkesat e pikës 1, më lart, aplikohen edhe kur në legjislacionin shqiptar janë miratuar skema të tjera të dokumentimit të zënieve.

Neni 6

Rieksporti i produkteve peshkore

1. Në mënyrë që të rieksportohen produkte peshkore që përbëjnë një dërgesë të vetme, të transportuara të papërpunuara nga Shqipëria në Komunitet European, kur anija nuk ka flamur shqiptar, eksportuesi duhet të paraqesë në autoritetet e Shtetit Anëtar importues:

a) certifikatën(at) e zënies(ve) që ka(në) marrë vlefshmërinë nga Shteti Flamur me informacionin e specifikuar të paraqitur në Shtojcën III, bashkëlidhur kësaj rregulloreje dhe

b) evidenca të dokumentuara që produkti peshkor nuk i është nënshtruar aktiviteteve të tjera, përveç shkarkimit, dhe ringarkimit apo, ndonjë aktiviteti tjetër që shërben për ta ruajtur atë në gjendjen e mirë fillestare, dhe që ka qëndruar nën mbikqyrjen e autoriteteve kompetente në vendin e tretë.

Evidencat e dokumentuara do të paraqiten në autoritetet e Shtetit Anëtar importues me anë të:

(i) ku është e përshtatshme, një dokumenti të vetëm transporti i lëshuar për të mbuluar kalimin nga territori i Shtetit flamur përmes Shqipërisë, ose

(ii) një dokument i lëshuar nga autoritetet doganore dhe veterinare që përmban:

a) një përshkrim të saktë të produktit peshkor, datën e shkarkimit dhe të ringarkimit të produktit dhe, aty ku është e aplikueshme, emrin e anijes, apo të mjeteve të tjera të transportit të përdorura, dhe

b) kushtet në të cilat produkti peshkor ka qëndruar në Shqipëri

Kur produktet peshkore në fjalë i nënshtrohen dhe një skeme të dokumentimit të zënieve të një organizate rajonale të menaxhimit të peshkimit e njohur në përputhje me Nenin 5 të rregullores, dokumentat e përmendur më sipër mund të zevendësohen me certifikatat e rieksportit të kësaj skeme të dokumentimit të zënieve, duke patur parasysh që vendi i origjinës së produkteve peshkore t'i ketë plotësuar afatet e njoftimeve në kohë.

2. Në mënyrë që të rieksportohen produkte peshkore që përbëjnë një dërgesë të vetme dhe të cilat janë përpunuar dhe transportuar nga Shqipëria në Komunitetin European, kur anija nuk ka flamur shqiptar, duhet të paraqitet në autoritetet e Shtetit Anëtar të importimit një deklaratë të hartuar në pikën e përpunimit në Shqipëri dhe të miratuara nga autoritetet doganore në përputhje me formën e përcaktuar në Shtojcën IV të kësaj rregulloreje duke:

a) dhënë një përshkrim të saktë të produkteve të përpunuara dhe të papërpunuara dhe të sasive të tyre respektive;

b) treguar që produkti i përpunuar është përpunuar në Shqipëri nga zënie të shoqëruara me certifikatën(at) e zënies(ve) që ka marrë vlefshmërinë nga Shteti flamur, dhe

c) u shoqëruar nga:

(i) certifikatat origjinale të zënieve kur e gjithë sasia e zënieve në fjalë është përdorur për përpunimin e produkteve peshkore të eksportuara në një dërgesë të vetme;

(ii) një kopje të certifikatës origjinale të zënieve, kur një pjesë e zënieve në fjalë janë përdorur për përpunimin e produkteve peshkore të eksportuara në një dërgesë të vetme

Kur produktet peshkore në fjalë i nënshtrohen dhe një skeme të dokumentimit të zënieve të një organizate rajonale të menaxhimit të peshkimit e cila është e njohur në përputhje me Nenin 5 të rregullores, dokumentat e përmendur më sipër mund të zevendësohen me certifikatat e rieksporit të kësaj skeme të dokumentimit të zënieve, duke patur parasysh që vendi i origjinës t'i ketë plotësuar afatet e njoftimeve në kohë.

3. Dokumentet dhe deklarata e parashikuar në respektivisht në pikat 1(b) dhe 2 të këtij Neni, mund të komunikohen me anë të mjeteve elektronike brenda kuadrit të bashkëpunimit.

Neni 7

Paraqitja dhe kontrolli i certifikatës së zënieve

1. Certifikata e zënieve e vlefshme paraqitet nga importuesi në autoritetet kompetente të Shtetit Anëtar në të cilin produkti mendohet të importohet, të paktën tre ditë pune para kohës së parashikuar të mbërritjes në pikën e hyrjes në territorin e Komunitetit. Afati prej tre ditë pune mund të përshtatet sipas llojit të produktit peshkor, distancës së pikës së hyrjes në territorin e Komunitetit, apo mjeteve të transportit të përdorura sipas shtojcës V të rregullores.

Neni 8

Verifikimet

1. Verifikimi do të përqendrohet drejt identifikimit të rrezikut mbi bazë të kriterëve të hartuara në nivel kombëtar apo komunitar nën menaxhimin e riskut.

2. Për të kryer verifikime, autoritetet kompetente të Shtetit Anëtar të BE mund të kërkojnë asistencën e autoriteteve kompetente shqiptare apo të një vendi të tretë të ndryshëm nga Shteti Flamur, siç është parashikuar në Nenin 6 të rregullores. Në këto raste:

a) kërkesa për ndihmë përmban arsyet që autoritetet kompetente të Shtetit Anëtar në fjalë kanë dyshime të bazuara mbi vlefshmërinë e certifikatës, të deklarimeve që përmban ajo dhe/ose të pajtueshmërisë së produkteve me masat menaxhuese dhe konservuese. Një kopje e certifikatës së zënieve dhe çdo informacion apo dokument që sugjeron se informacioni në certifikatë është i pasaktë do të transmetohet në mbështetje të kërkesës për ndihmë;

b) procedura e verifikimit plotësohet brenda 15 ditëve nga data e kërkesës për verifikim. Në rast se autoritetet kompetente shqiptare në fjalë nuk mund t'i përmbahen afateve, autoritetet verifikuese të Shtetit Anëtar munden, pas një kërkesë nga Shqipëria apo të një vendi të tretë të ndryshëm nga Shqipëria siç është parashikuar në Nenin 6, t'i akordojnë një zgjatje të afatit të përgjigjes, e cila nuk mund të jetë më shumë se 15 ditë të tjera.

3. Lëshimi i produktit në treg do të pezullohet në pritje të rezultateve, deri në përfundim të procedurave të verifikimit. Kostoja e ruajtjes do të përballohet nga operatori.

Neni 9

Refuzimi i importimit

1. Autoritetet kompetente të Shtetit Anëtar, kur nevojitet, refuzojnë importimin në Komunitet të produkteve të peshkimit pa kërkuar ndonjë të dhënë shtesë apo të dërgojnë një kërkesë për asistencë nga Shqipëria në rastet që ato janë në dijeni se:

a) importuesi nuk ka qenë në gjendje të paraqesë një certifikatë zënie për produktet në fjalë apo plotësimin e detyrimeve të parashikuar në Nenin 7 të rregullores;

b) produktet që mendohet të importohen nuk janë të njëjtë me ato të përmendura në certifikatën e zënieve;

c) certifikata e zënieve nuk ka marrë vlefshmërinë nga Inspektorati shqiptar i peshkimit;

d) certifikata e zënieve nuk i përmban të gjithë informacionet e kërkuara;

e) importuesi nuk është në gjendje të provojë se produktet e peshkimit janë në përputhje me kërkesat e pikës 1 dhe 2 të Nenit 6;

f) një anije peshkimi që ndodhet në certifikatën e zënieve si anije e origjinës së zënieve është e përfshirë në listën Komunitare të anijeve IUU;

g) certifikata e zënieve e ka marrë vlefshmërinë nga autoritetet e një Shteti Flamur të njohur si një Shtet jo-bashkëpunues.

2. Autoritetet kompetente të Shtetit Anëtar, kur nevojitet, refuzojnë importimin e produkteve peshkore në Komunitet, pasi kanë kërkuar ndihmë në përputhje me pikën 2 të Nenit 8, në rastet kur:

a) ata kanë marrë një përgjigje sipas së cilës eksportuesi nuk kishte autoritetin për të kërkuar marrjen e vlefshmërisë për certifikatën e zënies, ose;

b) ata kanë marrë një përgjigje sipas së cilës produktet nuk janë në përputhje me masat konservuese dhe menaxhuese, apo kushte të tjera që janë paraqitur në këtë Kre në fjalë nuk janë plotësuar, ose

c) ata nuk kanë marrë një përgjigje brenda datës së caktuar, ose

d) ata kanë marrë një përgjigje e cila nuk jep shpjegime të sakta në lidhje me pyetjet që janë paraqitur në kërkesë

3. Në rastet kur importimi i produkteve peshkore refuzohet konform pikës 1 ose 2, Shtetet Anëtare mund të konfiskojnë dhe shkatërrojnë, të eliminojnë apo të shesin këto produkte peshkore në përputhje me legjislacionin e tyre kombëtar.

4. Çdo person ka të drejtën për të apeluar kundër vendimeve të marra nga autoritetet kompetente të Shteteve Anëtare sipas pikave 1, 2 ose 3 që kanë lidhje me të. E drejta e apelimit do të ushtrohet duke u bazuar në dispozitat në fuqi të Shteteve Anëtare në fjalë.

5. Autoritetet kompetente të Shtetit Anëtar do të njoftojnë Shqipërinë dhe, aty ku është e nevojshme, vendet e treta të ndryshme nga Shqipëria, për refuzimet e importimit. Një kopje e njoftimit i dërgohet dhe Komisionit.

Neni 10

Dispozita te fundit

Kjo rregullore hyn ne fuqi menjehere dhe botohet ne Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I MJEDISIT, PYJEVE DHE
ADMINISTRIMIT TË UJËRAVE
Fatmir MEDIU

SHTOJCA I

LISTA E PRODUKTEVE TË PËRJASHTUARA NGA PËRKUFIZIMI SI “PRODUKTE PESHKORE” TË PËRCAKTUARA NË PIKËN 9 TË NENIT 2

Produkte peshkore të ujërave të ëmbla

- 0301 91 – Peshk tjetër i gjallë: Troftë (Salmo trutta, Oncorhynchus mykiss, Oncorhynchus clarki, Oncorhynchus aguabonita, Oncorhynchus gilae, Oncorhynchus apache dhe Oncorhynchus chrysogaster)

- 0301 92 – Peshk tjetër i gjallë: Ngjala (Anguilla spp.)

- 0301 92 – Peshk tjetër i gjallë: Krap

- ex 0301 99 – Të tjera: Peshk i ujërave të ëmbla (CN 0301 99 11 dhe 0301 99 19)

- 0302 11 – Peshk, i freskët apo i ftohtë, përjashto filetот e peshkut dhe mish tjetër prej peshkut të kreut Nr. 0304: Troftë (Salmo trutta, Oncorhynchus mykiss, Oncorhynchus clarki, Oncorhynchus aguabonita, Oncorhynchus gilae, Oncorhynchus apache dhe Oncorhynchus chrysogaster)

- 0302 12 – Peshk, i freskët apo i ftohtë, përjashto filetот e peshkut dhe mish tjetër prej peshkut të kreut Nr. 0304: Salmon i Paqësorit (Oncorhynchus nerka, Oncorhynchus gorbuscha,

Oncorhynchus keta, Oncorhynchus tshawytscha, Oncorhynchus kisutch, Oncorhynchus masou dhe Oncorhynchus rhodurus), salmoni i Atlantikut (Salmo salar) dhe salmoni i Danubit (Hucho hucho)

- 0302 66 – Peshk, i freskët apo i ftohtë, përjashto filetот e peshkut dhe mish tjetër prej peshkut të kreut Nr. 0304: Ngjala (Anguilla spp.)

- ex 0302 69 – Peshk, i freskët apo i ftohtë, përjashto filetот e peshkut dhe mish tjetër prej peshkut të kreut Nr. 0304: Peshk i ujërave të ëmbla (CN 0302 69 11 dhe 0302 69 19)

- 0303 11 – Peshk, i ngrirë, përjashto filetот e peshkut dhe mish tjetër prej peshkut të kreut nr.0304: Salmon i Paqësorit (Oncorhynchus nerka, Oncorhynchus gorbuscha, Oncorhynchus keta, Oncorhynchus tshawytscha, Oncorhynchus kisutch, Oncorhynchus masou dhe Oncorhynchus rhodurus), përjashto mëlçitë dhe vezët

- 0303 21 – Peshk, i ngrirë, përjashto filetот e peshkut dhe mish tjetër prej peshkut të kreut Nr. 0304: Troftë (Salmo trutta, Oncorhynchus mykiss, Oncorhynchus clarki, Oncorhynchus aguabonita, Oncorhynchus gilae, Oncorhynchus apache dhe Oncorhynchus chrysogaster)

- 0303 22 – Peshk, i ngrirë, përjashto filetот e peshkut dhe mish tjetër prej peshkut të kreut Nr. 0304: Salmoni i Atlantikut (Salmo salar) dhe Salmoni i Danubit (Hucho hucho)

- 0303 76 – Peshk, i ngrirë, përjashto filetот e peshkut dhe mish tjetër prej peshkut të kreut Nr. 0304: Ngjala (Anguilla spp.)

- ex 0303 79 – Peshk, i ngrirë, përjashto filetот e peshkut dhe mish tjetër prej peshkut të kreut Nr. 0304: Peshk i ujërave të ëmbla (CN 0303 79 11 dhe 0303 79 19)

- ex 0304 19 – Fileto peshku dhe mish tjetër peshku (nëse është apo jo i grirë), i freskët apo ftohtë: Peshk i ujërave të ëmbla (CN 0304 19 13; 0304 19 15; 0304 19 17; 0304 19 19 dhe 0304 19 91)

- ex 0304 29 – Fileto të ngrira: Peshk i ujërave të ëmbla (CN 0304 29 13; 0304 29 15; 0304 29 17 dhe 0304 29 19)

- ex 0304 99 – Mish tjetër prej peshku i ngrirë: Peshk i ujërave të ëmbla (CN 0304 99 21)

- ex 0305 30 – Fileto peshku, i tharë, i kripur apo në ujë me kripë, por jo i tymosur: Salmon i Paqësorit (Oncorhynchus nerka, Oncorhynchus gorbuscha, Oncorhynchus keta, Oncorhynchus tshawytscha, Oncorhynchus kisutch, Oncorhynchus masou dhe Oncorhynchus rhodurus), salmon i Atlantikut (Salmo salar), dhe salmon i Danubit (Hucho hucho), i kripur apo në ujë me kripë (CN 0305 30 30); troftë e llojeve Salmo trutta, Oncorhynchus mykiss, Oncorhynchus clarki, Oncorhynchus aguabonita, Oncorhynchus gilae, Oncorhynchus apache dhe Oncorhynchus chrysogaster; krap (ex CN 0305 30 90)

- ex 0305 41 – Peshk i tymosur, përfshirë filetот: Salmon i Paqësorit (Oncorhynchus nerka, Oncorhynchus gorbuscha, Oncorhynchus keta, Oncorhynchus tshawytscha, Oncorhynchus kisutch, Oncorhynchus masou dhe Oncorhynchus rhodurus), salmon i Atlantikut (Salmo salar) dhe salmon i Danubit (Hucho hucho)

- ex 0305 49 – Peshk i tymosur, përfshirë filetот: Troftë (Salmo trutta, Oncorhynchus mykiss, Oncorhynchus clarki, Oncorhynchus aguabonita, Oncorhynchus gilae, Oncorhynchus apache dhe Oncorhynchus chrysogaster) (CN 0305 49 45); ngjalë (Anguilla spp.) (CN 0305 49 50); Krap (ex CN 0305 49 80)

- ex 0305 59 – Peshk, i kriposur por jo i tharë apo i tymosur dhe peshk në ujë me kripë: Troftë (Salmo trutta, Oncorhynchus mykiss, Oncorhynchus clarki, Oncorhynchus aguabonita, Oncorhynchus gilae, Oncorhynchus apache dhe Oncorhynchus chrysogaster); krap (ex CN 0305 59 80)

- ex 0305 69 – Peshk, i tharë, i kripur apo jo, por jo i tymosur: Salmon i Paqësorit (Oncorhynchus nerka, Oncorhynchus gorbuscha, Oncorhynchus keta, Oncorhynchus tshawytscha, Oncorhynchus kisutch, Oncorhynchus masou dhe Oncorhynchus rhodurus), salmon i Atlantikut (Salmo salar) dhe salmon i Danubit (Hucho hucho) (CN 0305 69 50); troftë (Salmo trutta, Oncorhynchus mykiss, Oncorhynchus clarki, Oncorhynchus aguabonita, Oncorhynchus gilae, Oncorhynchus apache dhe Oncorhynchus chrysogaster); krap (ex CN 0305 69 80)

- ex 0306 19 – Krustace të tjera, duke përfshirë miellra, kokrriza dhe sfera të krustaceve të përshtatshme për konsum njerëzor, të ngrira: Gafore të ujërave të ëmbla (CN 0306 19 10)

- ex 0306 29 – Krustace të tjera, duke përfshirë miellra, kokrriza dhe sfera të krustaceve të përshtatshme për konsum njerëzor, jo të ngrira: Gafore të ujërave të ëmbla (CN 0306 29 10)
- 1604 11 00 – Peshk i përgatitur apo i konservuar, i tëri apo në copa, por jo i grirë: Salmon
- ex 1604 19 – Peshk i përgatitur apo i konservuar, i tëri apo në copa, por jo i grirë: Salmonidae, ndryshe nga salmoni (CN 1604 19 10)
- ex 1605 40 – Krustace të tjera të përgatitura apo të konservuara: Gafore të ujërave të ëmbla të gatuar me kopër, të ngrira
- Produkte akuakulture të marra nga larvat apo rasatet
- 0301 10 Peshk zbukurimi i gjallë
- Ostreat (gjinitë Ostrea, Crassostrea, Ostreola, Saccostrea), nëse janë apo jo në guackë, të gjalla, të freskëta, të ftohta, të ngrira, të thara, të kripura apo në ujë me kripë
- Freskoret (kërminj, duke përfshirë kërminj mbretëresha) të gjinive Pecten, Chlamys apo Placopecten,
- 0307 21 – Të gjalla, të freskëta apo të ftohta
- 0307 29 – Të tjera
- Midhjet
- 0307 31 – Të gjalla, të freskëta apo të ftohta
- 0307 39 – Të tjera
- ex 1605 90 – Të tjera (CN 1605 90 11 dhe 1605 90 19)
- 0307 60 00 – Kërminjtë, ndryshe nga kërminjtë e detit
- 0305 10 00 – Miell, kokrriza dhe sfera të peshkut, të përshtatshme për konsum njerëzor
- ex 1605 90 30 – Molusqe, krustace dhe jovertebrorë të tjerë ujorë, të përgatitur apo konservuar: freskoret, ostreat, kërminjtë
- 1605 90 00 – Jovvertebrorë të tjerë ujorë, të përgatitur apo të konservuar

SHTOJCA II

CERTIFIKATË E ZËNIEVE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË REPUBLIC OF ALBANIA CATCH CERTIFICATE

ÇERTIFIKATË E ZËNIEVE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË REPUBLIC OF ALBANIA CATCH CERTIFICATE			
Numri i Dokumentit Document Number		Autoriteti miratues Validating authority	
Emri Name	Adresa: Address	Tel. Fax:	
Emri i anijes së peshkimit Fishing vessel name	Flamuri – Porti bazë dhe numri i rregjistrimit Flag – Home port and registration number	Sinjali thirrjes Call sign	Nr. IMO/Lloyd (nëse ka) IMO/Lloyd's No. (if issued)
Nr. i lejes së peshkimit – i vlefshëm deri më Fishing license No. –Valid to	Nr. Inmarsat, Nr. Fax, Nr Tel., E-mail (nëse ka) Inmarsat No, Fax No, Telephone No, E-mail address (if issued)		
Përshkrimi i produktit Description of product	Lloji i përpunimit i autorizuar në bord Type of processing authorized on board	Referenca ligjore e masave menaxhuese dhe mbrojtëse References of applicable conservation and management measures	

Llojet Species	Kodi i produktit Product code	Zona dhe data e zënies Catch area(s) and date	Pesha e gjallë e vlerësuar (kg) Estimated live weight (kg)	Pesha e vlerësuar e zbarkuar (kg) Estimated weight to be landed (kg)	Pesha e verifikuar e zbarkuar e (aty ku nevojitet) Verified weight landed (kg) where appropriate		
Emri i kapitenit të anijes së peshkimit – Firma- Vula Name of master of fishing vessel-Signature-Seal:							
6.Deklarata e transferimit në det. Emri i kapitenit të anijes. Declaration of transhipment at sea Name of master of fishing vessel		Firma dhe data Signature and date	Data e transbordimit/ zona/ pozicioni. Transhipment date/area/position	Pesha e vlerësuar (kg) Estimated weight (kg)			
Kapiteni i anijes marrëse Master of receiving vessel	Firma Signature	Emri i anijes Vessel name	Sinjali i thirjes Call sign	Numri IMO (nëse ka) IMO/ Lloyds number (if issued)			
7. Autorizimet e transferimit brenda një porti Transhipment authorisation within a port area							
Emri Name	Autoriteti Authority	Firma Signature	Adresa Address	Tel. Tel.	Porti zbarkimit Port of landing	Data e zbarkimit Date of landing	Vula Seal (Stamp)
8.Emri dhe adresa e eksportuesit Name and address of exporter		Firma Signature	Data Date		Vula Seal		
9. Miratimi i autoritetit të shtetit flamur: Flag State authority validation:							
Emri/ titulli Name/title		Firma Signature	Data Date		Vula Seal (stamp)		
10. Detajet e transportit (shiko shtojcën II/a) Transport details (see Appendix)							
11. Deklarata e importuesit- Importer declaration							
Emri dhe adresa e importuesit Name and address of importer		Firma Signature	Data Date	Vula Seal	Kodi produktit CN Product CN code		
Dokumenta sipas pikes 1 dhe 2 të nenit 6, rregullore 9 Documents under article 14(1), (2) of Regulation (EC) No. 1005/2008		Referenca References					

12. Autoriteti i kontrollit të importit Import control-authority	Vendi Place	Importim i autorizuar(*) Importation authorized (*)	Importim i pezulluar (*) Importation suspended (*)	Kërkesë verifikimi – data Verification requested –date
Deklarimi i doganës (n.q.s. lëshohet) Customs declaration (if issued)	Numri Number	Data Date	Vendi Place	
(*) Shënohet aty ku nevojitet				

SHTOJCA II/a

DETAJET E TRANSPORTIT

1. Shteti Eksportues Country of exportation	2. Nënshkrimi i Eksportuesit Exporter signature			
Porti/aeroporti/pikë tjetër nisje Port/airport/other place of departure				
Emri dhe flamuri i anijes Vessel name and flag	Numri (at) i (e) konteinerit (ave) Container number(s)	Emri Name	Adresa Address	Nënshkrimi Signature
Numri i fluturimit/numri i faturës ajrore Flight number/airway bill number	Lista bashkangjitur List attached			
Numri i Regjistrimit dhe kombësia që ka kamioni Truck nationality and registration number				
Numri i faturës hekurudhore Railway bill number				
Dokumente të tjera transporti Other transport document				

SHTOJCA III

CERTIFIKATË E RIEKSPORTIT E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË REPUBLIC OF ALBANIA RE-EXPORT CERTIFICATE			
Numri i çertificates Certificate number	Data Date	Shteti i origjinës Origin state	
Përshkrimi i produktit të rieksportuar Description of re-exported product		Pesha (kg) Weight (kg)	
Llojet Speciet	Kodi i Produktit Product Code	Mbetja nga sasia totale e deklaruar në çertifikatën e zënies Balance from total quantity declared in the catch certificate	
Emri i rieksportuesit Name of re-exporter	Adresa Address	Firma Signature	Data Date
Autoriteti Authority			
Emri/Titulli Name/Title	Firma Signature	Data Date	Vula Seal/stamp
Kontrolli i rieksporit Re-export control			
Vendi Place	Riekспорт i autorizuar(*) Re-export authorized	Verifikim i kërkuar Verification requested	Deklaratë e rieksporit numër date Re-export declaration number and date
(*) shëno sipas rastit			

SHTOJCA IV

Unë konfirmoj se produktet e peshkimit e përpunuara....(përshkrimi i produktit dhe kodi i Nomenklaturës së Kombinaruar)... janë siguruar nga zënie të importuara sipas certifikatës(ave) të mëposhtme:

Numri i certifikatës së zënies	Emri(at) dhe Flamuri(ët) e anijes(ve)	Data e vlefshmërisë	Përshkrimi i zënieve	Pesha totale e zbarkuar (kg)	Zëniet e përpunuara (kg)	Produkti peshkor i përpunuar (kg)

Emri dhe adresa e qendrës së përpunimit

.....

Emri dhe adresa e eksportuesit (nëse është e ndryshme nga ajo e qendrës)

.....

Numri i aprovimit i qendrës së përpunimit

.....

Numri dhe data e certifikatës veterinare

.....

Personi përgjegjës i qendrës së përpunimit:	Nënshkrimi:	Data:	Vendi:

Miratimi nga autoriteti kompetent

.....

Zyrtari:	Nënshkrimi dhe Vula:	Data:	Vendi:

SHTOJCA V

PERIUDHA E PARAQITJES TË ÇERTIFIKATËS SË ZËNIEVE PËR DËRGESAT E PARASHIKUARA NË NENIN 7

Afati katër orë para mbërritjes në territorin e Komunitetit Europian

Dërgesat e produkteve peshkore që mbërrijnë në komunitet me rrugë ajrore

Afati dy orë para mbërritjes në territorin e Komunitetit Europian

Dërgesat e produkteve peshkore që mbërrijnë në komunitet me rrugë tokësore

Afati katër orë para mbërritjes në territorin e Komunitetit Europian

Dërgesat e produkteve peshkore që mbërrijnë në komunitet me rrugë hekurudhore

Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi "Gjergj Fishta", mbrapa ish-ekspozitës "Shqipëria Sot", tel: 04 24 27 003.

Çmimi i abonimit në postë për Fletoret Zyrtare 2010 është 16 000 lekë.

Çmimi i abonimit në QPZ është 14 000 lekë pa detyrimin e shpërndarjes në adresa.

BOTIMET E QENDRËS SË PUBLIKIMEVE ZYRTARE

KODI I PROCEDURËS CIVILE	240 lekë
KODI PENAL	226 lekë
KODI I PROCEDURËS PENALE.....	330 lekë
KODI CIVIL	410 lekë
KODI I PUNËS	140 lekë
KODI PENAL USHTARAK	55 lekë
KODI I FAMILJES	270 lekë
KUSHTETUTA	95 lekë
KODI I PROCEDURËS ADMINISTRATIVE	90 lekë
PËRMBLEDHËSE PËR KTHIMIN DHE KOMPENSIMIN E PRONAVE	140 lekë

Hyri në shtyp më 24.2.2010
Doli nga shtypi më 25.2.2010

Tirazhi: 3000 copë	Formati: 61x86/8
--------------------	------------------

Shtypshkronja ADEL PRINT
Tiranë, 2010

Çmimi 38 lekë